



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



Kingdom of the Netherlands



PANDEMI NË GJYQËSI

Raport i monitorimit në
gjykatat themelore në
Republikën e Kosovës
shtator 2019 – gusht 2020

2020

PANDEMI NË GJYQËSI



Raport i monitorimit në
gjykatat themelore në
Republikën e Kosovës
shtator 2019 – gusht 2020

2020



Deklaratë mohimi:

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Ambasadës Holandeze në Kosovë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e organizatës Çohu! dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të donatorit.



Kingdom of the Netherlands

Autorë:

Rina Koliqi dhe Genc Nimoni

Monitorues:

Drilon Dobruna, Artan Sufaj, Albana Krasniqi, Lirie Aliu

Lekturoi:

Qerim Ondozi

Origjinali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

Organizata për Demokraci, Antkorrupsion dhe Dinjitet,
Çohu!

Rruga: Perandori Dioklecian nr:49; Prishtinë, Kosovë

Tel / +383 (0)38 248 506

www.cohu.org

SHKURTESAT

KGJK

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

KPK

Këshilli Prokurorial i Kosovës

ÇOHU!

Organizata për Demokraci,
Anti-korrupsion dhe Dinjitet

GJTH

Gjykata Themelore

TI

Transparency International

PTH

Prokuroria Themelore

WJP

World Justice Project

PSRK

Prokuroria Speciale e Republikës së
Kosvës

USAID

The United States Agency
for International Development

KPRK

Kodi Penal i Republikës së Kosovës

PËRMB

Lista e shkurtesave.....	5
Përmbledhje ekzekutive	8
Hyrje	10
1.Sundimi i ligjit	12
Sundimi i ligjit në Kosovë dhe aspektet krahasimore.....	12
2. Efektet pandemike në gjyqësor (COVID-19)	17
2.1 Shtyrja dhe mosmbajtja e seancave gjyqësore	18
2.2 Dukuria e parashkrimit të lëndëve.....	20
3. Vonesat në fillimin e seancave gjyqësore.....	22
3.1 Ndërprerja dhe shtyrja e seancave gjyqësore.....	25

BAJTTJA

4. Shkelja e afateve ligjore	32
4.1 Shkelja e afatit në shqyrtimin fillestar	32
4.2 Shkelja e afatit në shqyrtimin dytësor	33
4.3 Shkelja e afatit në shqyrtimin kryesor dhe në përfundimin e tij	34
5. Ndërrimi i prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave.....	36
6. Rastet e profilit të lartë – Korrupsioni i nivelit të Lartë.....	38
7. Performanca e prokurorëve dhe gjykatësve në procedimin dhe trajtimin e rasteve	40
ANEKS	42
Rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar ndër vite.....	44
Rastet e korrupsionit ndër vite	44
Rastet e krimit të organizuar ndër vite.....	48

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu! (tutje në tekst Organizata Çohu!), ka vazhduar monitorimin e gjykatave themelore të Republikës së Kosovës duke u përqendruar në rastet e korrupsionit si dhe rastet e krimit të organizuar.

Monitorimi i tërësishëm dyvjeçar është i ndarë në dy periudha kohore, në periudhën tetor 2018 - shtator 2019; dhe në periudhën e dytë, gjegjësisht shtator 2019 – gusht 2020. Gjatë periudhës dyvjeçare, tetor 2018 – gusht 2020, monitorimi i Organizatës Çohu! është bërë në baza ditore me ç’rast janë monitoruar gjithsej 371 raste me 946 seanca gjyqësore në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Prizren, Gjilan dhe Gjakovë.

Gjatë periudhës së dytë të monitorimit, shtator 2019 – gusht 2020, Organizata Çohu! ka monitoruar gjithsej 93 raste me 317 seanca gjyqësore në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Prizren, Gjilan dhe Gjakovë. Periudha e dytë e monitorimit është karakterizuar me mungesë të theksuar të mbajtjes së seancave gjyqësore, atyre të korrupsionit dhe krimit të organizuar për shkak të situatës me pandeminë COVID-19. Monitorimi ka identifikuar gjetje të ndryshme, duke filluar nga ato më teknike, siç është vonesa në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore, e deri të shkeljet e afateve procedurale ligjore dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

Duke u bazuar në rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2019, publikuar nga Transparency International (TI), Republika e Kosovës ka shënuar regres në luftimin e korrupsionit, me ç’rast nga pozita 93 në vitin 2018, ka zbritur në vendin 101 në vitin 2019¹.

Sundimi i ligjit dhe mungesa e luftimit dhe ndëshkimit të korrupsionit janë identifikuar edhe në raportet e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit si dhe atë

të Komisionit Evropian, i njohur si Raporti për vendin.² Për shkak të pandemisë COVID-19, në gjykatat dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës është vështirësuar puna në trajtimin e lëndëve, dhe për një kohë të gjatë fokusi ka qenë vetëm në trajtimin e lëndëve me karakter emergjent: lëndëve me paraburgim, urdhrave mbrojtës si dhe rasteve të tjera të cilat sipas ligjit duhet të trajtohen me urgjencë. KGJK-ja më 2 qershor 2020 miratoi Planin e Veprimit për Menaxhimin e Krizës. Megjithatë, gjyqësori është duke u ballafaquar me rënien e madhe të efikasitetit në trajtimin e lëndëve për shkak të kapaciteteve të kufizuara. Korrupsioni i nivelit të lartë mbetet ndër sfidat madhore të drejtësisë e cila vazhdon të ketë efekte në stagnim të zhvillimit të vendit. Organizata Çohu! gjatë monitorimit të gjykatave themelore në periudhën shtator 2019 – gusht 2020 ka identifikuar 16 raste të korrupsionit të nivelit të lartë. Trajtimi i lëndëve të korrupsionit të nivelit të lartë nga gjykatat është përcjellë me vonesa, ndërprerje dhe shtyrje të seancave si dhe shkelje të afateve ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Organizata Çohu! ka trajtuar dhe ka analizuar të dhënat e KGJK-së dhe KPK-së ndër vite. Nga këto të dhëna vërehet se përkundër prioritetit që do duhej të kishin lëndët e korrupsionit dhe krimit të organizuar, ato megjithatë vazhdojnë të barten nga viti në vit.

Rekomandimet e përfshira në raport adresojnë gjetjet për institucionet kryesore si KGJK-ja, KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë dhe institucionet e tjera, me qëllim të përmirësimit të efektivitetit të masave për luftimin e dukurive kriminale siç është krimi i organizuar dhe korrupsioni. Këto rekomandime po ashtu janë të orientuara drejt respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe drejt parandalimit të shkeljes së legjislacionit në fuqi.



Organizata Çohu! gjatë monitorimit të gjykatave themelore në periudhën shtator 2019 – gusht 2020 ka identifikuar 16 raste të korrupsionit të nivelit të lartë.

² <https://www.transparency.org/en/cpi/2019/results>.



HYRJE

Korrupsioni dhe krimi i organizuar në Kosovë vazhdojnë të pengojnë zhvillimin e vendit përkundër përpjekjeve dhe reformave të ndërmarra në fushën e drejtësisë.

Këto forma të kriminalitetit janë dukuri me rrezikshmëri të lartë shoqërore për qytetarët, institucionet, ekonominë, sigurinë kombëtare dhe atë ndërkom-bëtare. Niveli i theksuar i korrupsionit dhe krimit të organizuar, vazhdon të mbetet shqetësim në funksionimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Ndonëse lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është ndër kushtet e vëna për nga Bashkimi Evropian në drejtim të liberalizimit të vizave dhe integrimin në këtë mekanizëm, Republika e Kosovës vazhdon të ketë institucione të brishta dhe politika të paqëndrueshme për ndjekjen dhe ndëshkimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në vend.

Gjatë monitorimit të 93 rasteve me 371 seanca gjyqësore në gjykatave themelore të Republikës së Kosovës gjatë periudhës shtator 2019 – gusht 2020, Organizata Çohu! ka vazhduar të identifikojë probleme siç janë vonesat e fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe shtyrja e tyre, ndërprerjet e seancave gjyqësore, numri i madh i lëndëve, papërgatitja e prokurorëve për seanca gjyqësore, shkelja e dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me afatet ligjore të procedimit të rasteve si dhe shkelja e të drejtave të njeriut.

Nga fundi i marsit të vitit 2020, sistemit të drejtësisë

në Republikën e Kosovës për shkak të pandemisë COVID-19 i është vështirësuar puna në trajtimin e lëndëve. Fokusi ka mbetur vetëm te trajtimi i lëndëve me paraburgim, urdhrave mbrojtës si dhe rasteve të tjera të cilat sipas ligjit duhet të trajtohen me urgjencë. Përkundër përpjekjeve, gjyqësori është duke u ballafaquar me rënien e madhe të efikasitetit në trajtimin e lëndëve për shkak të kapaciteteve të kufizuara.

Të dhënat që i ka siguruar Preportri i cili operon në kuadër të Organizatës Çohu! tregojnë se në gjykatat e Kosovës deri në fund të vitit 2020 ka rrezik të parashkruhen 492 lëndë (443 lëndë me parashkrim absolut dhe 49 me parashkrim relativ)³.

Organizata Çohu! gjatë monitorimit të gjykatave themelore në periudhën shtator 2019 – gusht 2020 ka identifikuar 16 raste të korrupsionit të nivelit të lartë. Trajtimi i këtyre lëndëve vazhdon të ballafaqohet me zvarritje të procese gjyqësore dhe me një drejtësi jo-efikase.

Qytetarët vazhdojnë të ballafaqohen me problemin e zvarritjes së procedurave gjyqësore dhe me drejtësi joefikase. Megjithatë, duke u bazuar në gjetjet e Organizatës Çohu!, deri më tani nuk ka pasur asnjë rast kur mekanizmat për vlerësimin e performances së KPK-së dhe KGJK-së kanë shkarkuar nga puna ndonjë prokuror apo gjykatës për shkak të performancës së tyre të dobët.

³ Qindra lëndë mund të parashkruhen deri në fund të vitit", Preportri, korrik 2020 - http://preportri.cohu.org/repository/docs/09_-_Preportri_-_No_35_-_Parashkrimi_-_04_466857.pdf

Analiza dhe krahasimi i procedimit i të dhënave nga KPK-ja dhe KGJK-ja nga kapitujt të cilët kanë qenë në fokus të monitorimit është bërë gjithashtu për të gjitha lëndët në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore për periudhën 2015–2020.

Duke u bazuar në gjetjet e monitorimit dhe analizën e të dhënave, raporti jep rekomandime duke vënë në pah gjetjet kryesore dhe adresimin e tyre nga institucionet relevante të zbatimit të ligjit.



Gjatë monitorimit të 93 rasteve me

371 seanca

gjqësore në gjykatave themelore të Republikës së Kosovës gjatë periudhës shtator 2019 – gusht 2020, Organizata Çohu! ka vazhduar të identifikojë probleme siç janë vonesat e fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe shtyrja e tyre, ndërprerjet e seancave gjyqësore, numri i madh i lëndëve, papërgatitja e prokurorëve për seanca gjyqësore, shkelja e dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me afatet ligjore të procedimit të rasteve si dhe shkelja e të drejtave të njeriut.

1. SUNDIMI I LIGJIT

Sundimi i ligjit në Kosovë dhe aspektet krahasimore

Sundimi i ligjit në Republikën e Kosovës vazhdon të jetë ndër problemet kryesore më të cilin ballafaqohet shteti i ri. Pothuajse çdo sektor i shoqërisë është hisedar në sundimin e ligjit, duke përfshirë sektorin publik, atë biznesor/privat dhe të tjerë.

Sundimi i ligjit përmban elemente të ndryshme dhe ka përkufizime të ndryshme. Por, njëri ndër përkufizimet më të njohura dhe të pranueshme, është ai i Organizatës së Kombeve të Bashkuara – OKB. Sipas OKB-së, *“Sundimi i ligjit është parim i qeverisjes në të cilin të gjithë personat, institucionet dhe subjektet, publike dhe private, duke përfshirë vetë shtetin, janë përgjegjës për ligjet të cilat nxirren publikisht, zbatohen në mënyrë të barabartë dhe gjykojnë në mënyrë të pavarur, si dhe që janë në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. E gjithë kjo kërkon masa për të siguruar respektimin e parimeve të epërsisë së ligjit, barazinë para ligjit, përgjegjshmërinë ndaj ligjit, drejtësinë në zbatimin e ligjit, ndarjen e pushteteve, pjesëmarrjen në vendimmarrje, sigurinë juridike, shmangien e arbitraritetit si dhe transparencën procedurale dhe ligjore”.*⁴

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 12 vjet nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe 21 vjet nga përfundimi i luftës, me progres të vogël në disa fusha, Republika e re vazhdon të çalojë në fushat kryesore të sundimit të ligjit siç është shkalla e lartë e pandëshkueshmërisë së korrupsionit të nivelit të lartë, ndërhyrjet politike në drejtësi, nepotizmi në administratën publike dhe mungesa e llogaridhënies në degët kryesore të pushtetit, atë ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ, e kështu me radhë.

Diçka e tillë është konstatuar edhe në raporte vendore dhe ndërkombëtare, në veçanti në indekset apo matës ndërkombëtarë të sundimit të ligjit dhe korrupsionit.

Duke u bazuar në rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2019 të publikuar nga Transparency International (TI), Republika e Kosovës ka shënuar regres në luftimin e korrupsionit, me ç’rast nga vendi 93 në vitin 2018 ka zbritur në vendin 101 në vitin 2019.⁵

Sipas po këtij publikimi, Republika e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me probleme të theksuara në fushën e sundimit të ligjit, me institucione të brishta të sundimit të ligjit, nivel të lartë të pandëshkueshmërisë së rasteve të korrupsionit, mungesë të llogaridhënies së zyrtarëve publikë, transparencë të pamjaftueshme dhe ngushtim të hapësirës për pjesëmarrje qytetare.⁶ Tutje, sipas rezultateve të këtij indeksi, Republika e Kosovës

4 United Nations and the Rule of Law - <https://www.un.org/ruleoflaw/what-is-the-rule-of-law/>.

5 KOSOVA NË CPI – VAZHDON REGRESI NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT - <http://kdi-kosova.org/aktivitetet/kosova-ne-cpi-vazhdon-regresi-ne-luften-kunder-korrupsionit/>.

6 Ibid.

ndan pozitën e njëjtë me pikë të njëjta me Bosnjën, Panamanë, Perunë dhe Tajlandën.⁷

Sundimi i ligjit dhe mungesa e luftimit dhe ndëshkim-it të korrupsionit, janë identifikuar edhe në raportet e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit si dhe në atë të Komisionit Evropian, të njohur si Raporti për vendin.

Sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2019, edhe pse ekziston baza ligjore për ndjekjen dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, problem mbetet mungesa e zbatimit të ligjit. Në raport theksohet se mungesa e një mbikëqyrje efektive gjyqësore si dhe problemet tjera me sundimin e ligjit, vazhdojnë t'i kontribuojnë në përgjithësi kësaj problematike, duke theksuar kështu faktin e apelimit të vazhdueshëm të rasteve të korrupsionit në instancat më të larta të gjykatave si dhe parashkrimin e rasteve.⁸

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2019 thekson problemet me sundim të ligjit në Kosovë, administrimin joefikas dhe të ngadaltë të drejtësisë si dhe nevojën për përpjekje të vazhdueshme për ngritje të kapaciteteve të institucioneve të sundimit të ligjit.⁹ Sa i përket funksionimit të gjyqësorit, raporti tutje identifikon se Kosova është në fazë të hershme të zhvillimit të një sistemi funksional gjyqësor, duke përmendur pak progres të arritur në vitin 2018.¹⁰

Në vitin 2019, Republika e Kosovës është inkorporuar në matësin/indeksin e sundimit të ligjit në kuadër të projektit për drejtësi botërore (Rule of Law Index - World Justice Project). Projekti i tillë ka për qëllim ka ofrimin e një pasqyre të sundimit të ligjit për 128 vende të ndryshme.

Rezultatet e kësaj platforme bazohen në 8 faktorë të ndryshëm: kufizimet e pushtetit të qeverisë, mungesa e korrupsionit, transparenca e qeverisë, të drejtat themelore, rendi dhe siguria, zbatimi i rregullativës (ligjore dhe administrative), drejtësia civile si dhe drejtësia penale.¹¹

Të gjithë këta faktorë janë matës të veçantë, të cilët si tërësi kompletojnë portretin e sundimit të ligjit, si një ndër fushat kryesore të funksionimit të shtetit dhe të së drejtës. Faktorët më me pak pikë të këtij indeksi, të cilët realisht edhe mbeten shqetësimi me i madh në Republikën e Kosovës janë korrupsioni, kufizimet e qeverisë, drejtësia civile si dhe mungesa e zbatueshmerisë së rregullativës. Derisa korrupsioni i zyrtarëve në ekzekutiv, gjyqësor, legjislativ dhe polici e rend radhitet në pozitën 62 në indeks,¹² problemet me zbatueshmerinë e rregullativës ligjore, përkatësisht mungesën e implementimit të ligjeve dhe rregulloreve e vendimeve administrative, qëndrojnë në fund të renditjes në mesin e faktorëve si matës të sundimit të ligjit, përkatësisht në vendin 97 nga gjithsej 128 vendet e përfshira në indeks.¹³

Në tabelën në vijim janë pasqyruar pikët dhe renditja e Republikës së Kosovës për të gjithë 8 faktorët e inkorporuar në vlerësim.

7 <https://www.transparency.org/en/cpi/2019/results>.

8 Seksioni IV – Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri - Raporti i Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut për vitin 2019 – Kosova; mars 2020; https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/?fbclid=IéAR3TÉ1077j0tpHazFFqf1UKPPOM6ag_akeky96LG65YRÉH2qAy6Qrz4PQv4#.XmkyUÉHC_BM.facebook.

9 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2019, Bruksel, 29.5.2019 https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/COUN-TRY_19_2776.

10 Ibid.

11 World Justice Project - <https://worldjusticeproject.org/>.

12 Absence of Corruption - <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2020/Kosovo/Absence%20of%20Corruption/>.

13 Regulatory Enforcement - <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2020/Kosovo/Regulatory%20Enforcement/>.



WJP - Indeksi i Sundimit të Ligjit - Republika e Kosovës 2020

Faktorët	Pikët sipas faktorit	Renditja sipas faktorit	Renditja regjionale	Grupimi sipas kategorizimit të Bankës Botërore (Income Rank) ¹⁴
1. Kufizimet e pushtetit të qeverisë	0.52	71/128	2/14	21/42
2. Korrupsioni	0.46	62	5	22
3. Transparenca e qeverisë	0.56	44	3	11
4. Të drejtat themelore	0.59	52	3	15
5. Rendi dhe siguria	0.84	25	2	1
6. Zbatimi i legjislacionit (ligjet dhe aktet administrative)	0.44	97	10	36
7. Drejtësia civile	0.46	93	13	34
8. Drejtësia penale	0.47	56	4	18
Renditja e përgjithshme	0.54	54/128	2/14	17/42

Tabela 1: Indeksi i Sundimit të Ligjit - Republika e Kosovës 2020

Ashtu siç janë paraqitur në tabelë, disa matës si rendi dhe siguria, transparenca e qeverisë si dhe të drejtat themelore, Republikën e Kosovës e pozicionojnë pozitivisht, mbi mesataren e 128 vendeve të përfshi-

ra në vlerësim. Derisa transparenca në qeveri e rendit Kosovën në vendin 44 në nivel global,¹⁵ rendi dhe siguria në Republikën e Kosovës renditen në vendin 18 nga gjithsej 128 vendet,¹⁶ duke e pozicionuar kështu

14 Shënim: Grupimi apo renditja sipas të hyrave (Income Rank), është klasifikim që bazohet në metodologjinë e Bankës Botërore në bazë të të cilit Republika e Kosovës radhitet në kategorinë e ekonomive mbimesatare (upper-middle - <https://datatopics.worldbank.org/world-development-indicators/stories/the-classification-of-countries-by-income.html>). Duke përdorur këtë kategorizim i cili identifikon katër grupe (high, upper-middle, lower-middle, and low), World Justice Project rendit Kosovën në grupin e dytë, përkatësisht atë mbimesatar (upper-middle) ku hyjnë 42 vende (https://worldjusticeproject.org/sites/default/files/documents/WJP-ROLI-2020-Online_0.pdf). Republika e Kosovës renditet në vendin 17 në renditjen e përgjithshme të këtij matësi (Rule of Law Index – World Justice Project), kategorizim që është bërë edhe sipas faktorëve të pasqyruar edhe në tabelën përkatëse.

15 Open Government - <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2020/Kosovo/Open%20Government/>.

16 Order and Security - <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2020/Kosovo/Order%20and%20Security/>.

Kosovën të dytën në rajon në renditjen e përgjithshme dhe në pozitën 54 në nivelin global.¹⁷

Sa i përket renditjes së përgjithshme të të gjitha vendeve të përfshira në vlerësim, vendet skandinave si Danimarka (90 pikë), Norvegjia (89) dhe Finlanda

(87) janë tri vendet e para me shkallën më të lartë të sundimit të ligjit. Rënditja e vendeve (3 vendet e para, Republika e Kosovës si dhe 3 vendet e fundit), janë paraqitur në tabelën në vijim:

WJP - Indeksi i Sundimit të Ligjit sipas vendeve 2020

Vendi	Pikët	Rënditja e përgjithshme	Rënditja regjionale	Grupimi sipas të hyrave (Income Rank)
1. Danimarka	0.9	1/128	1/24	1/37
2. Norvegjia	0.89	2/128	2/24	2/37
3. Finlanda	0.87	3/128	3/24	3/37
54. Kosova	0.54	54/128	2/14	17/42
126. RD e Kongos	0.34	126/128	31/31	19/19
127. Kamboxhia	0.33	127/128	15/15	30/30
128. Venezuela	0.27	128/128	30/30	42/42

Tabela 2: Indeksi i Sundimit të Ligjit sipas vendeve

3 vendet e fundit në mesin e 128 vendeve të përfshira në vlerësim janë Republika Demokratike e Kongos (34 pikë), Kamboxhia (33) dhe Venezuela (27 pikë), me numrin më të ulët të pikëve në matësin për sundim të ligjit.¹⁸

Sipas këtij matësi (Rule of Law Index), Republika e Kosovës ka shënuar progres në disa fusha të sundimit të ligjit, siç është transparenca e qeverisë e cila përfshin qasjen në informata, pjesëmarrjen e qytetarëve në politikat publike dhe llogaridhënien e qeverisë,

¹⁷ World Justice Project – Rule of Law Index - <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2020/Kosovo/>.

¹⁸ World Justice Project Rule of Law Index@ 2020, faqe 6 dhe 7 - https://worldjusticeproject.org/sites/default/files/documents/ËJP-ROLI-2020-Online_0.pdf.





Sipas këtij matësi (**Rule of Law Index**), Republika e Kosovës ka shënuar progres në disa fusha të sundimit të ligjit, siç është transparenca e qeverisë e cila përfshinë qasjen në informata, pjesëmarrjen e qytetarëve në politikat publike dhe llogaridhënien e qeverisë, rendi dhe siguria që përfshinë sigurinë e personave dhe të pronës, si dhe respektimi i të drejtave themelore të qytetarëve si faktorë të ranguar mbi mesataren e vendeve të përfshira në studim

rendi dhe siguria që përfshin sigurinë e personave dhe të pronës, si dhe respektimi i të drejtave themelore të qytetarëve si faktorë të ranguar mbi mesataren e vendeve të përfshira në studim.¹⁹

Sidoqoftë, Republika e Kosovës vazhdon të ketë probleme serioze me disa faktorë të tjerë, ku dominon korrupsioni i zyrtarëve në degën ekzekutive, gjyqësore dhe atë legjislativë, dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të implementimit të rregullativës – asaj ligjore dhe administrative.²⁰

Republika e Kosovës vazhdon të konsiderohet ndër vendet të cilat kanë probleme me sundimin e ligjit. Mungesa e rezultateve kualitative të prokurorive dhe gjykatave sa i përket luftimit dhe ndëshkimit të korrupsionit, ndikimit politik në sistemin e drejtësisë dhe punësimeve në administratën publike, keqpërdorimeve me paranë publike si dhe mungesës së llogaridhënies së prokurorëve dhe gjykatësve, vazhdojnë të kontribuojnë në brishtësinë e sundimit të ligjit në Kosovë.

Për shkak të problemeve të tilla, Republika e Kosovës vazhdon të ketë pasoja të cilat rezultojnë me mungesë të efikasitetit dhe besimit në sistemin e drejtësisë, me zvarritjen dhe grumbullimin e rasteve në gjykata, me mungesën e investimeve të huaja në Kosovë si dhe me përsëritjen e vazhdueshme të akteve korruptive si pasojë e pandëshkueshmërisë.

19 World Justice Project – Rule of Law Index - <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2020/Kosovo/>.

20 Ibid.

2. EFEKTET PANDEMIKE NË GJYQËSOR (COVID-19)

Në gjykatat dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës është vështirësuar puna në trajtimin e lëndëve për shkak të pandemisë COVID-19. Për një kohë të gjatë fokusi ishte vetëm te trajtimi i lëndëve me paraburgim, urdhrave mbrojtës si dhe te rastet e tjera të cilat sipas ligjit duhet të trajtohen me urgjencë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës mori vendim që të kufizohet veprimtaria në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës menjëherë pas paraqitjes së rasteve të para të virusit COVID-19. Si rrjedhojë, në gjykata themelore për një kohë të gjatë janë trajtuar vetëm lëndë të karakterit urgjent.²¹

Duke u nisur nga kjo, si rezultat i pandemisë COVID-19, më 2 qershor 2020 KGJK-ja miratoi Planin e Veprimit për Menaxhimin e Krizës. Megjithatë, gjyqësori gjatë kohës së pandemisë wshtë ballafaquar me rënie të madhe të efikasitetit në trajtimin e lëndëve për shkak të kapaciteteve të limituara.²²

Gjatë monitorimit, Organizata Çohu! ka identifikuar ngecje në efikasitetin e punës së gjyqësorit, probleme në caktimin dhe mbajtjen e seancave gjyqësore, pa-

mundësi të dërgimit të ftesave palëve, parashkrim të lëndëve si dhe dukuri të tjera të cilat vështirojnë në masë të madhe punën e mirëfilltë të gjyqësorit.

Nga të dhënat e siguruar nga monitorimi shihet se, përkundër përpjekjeve të gjyqësorit të Kosovës, procesi i menaxhimit të situatës pandemike nuk ka qenë efikas. Pandemia COVID-19 vazhdon të shkaktojë zvarritje të proceseve gjyqësore si dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Si pasojë e pandemisë kanë dështuar të mbahen seanca gjyqësore, janë parashkruar lëndë të korrupsionit të cilat nga institucionet përkatëse do të duhej të trajtoheshin me prioritet si dhe lëndë të cilat rrezikohen të parashkruhen. Duke u bazuar në të dhënat që Organizata ÇOHU! dhe Preprotr kanë siguruar në gjykata, vetëm në gjykatat themelore në Gjilan, Gjakovë, Ferizaj dhe Pejë deri në fund të vitit 2020 rrezikojnë të parashkruhen 492 lëndë. Gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren nuk kanë kthyer përgjigje për lëndët që rrezikojnë të parashkruhen. As Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka kthyer përgjigje.²³

21 Mbledhja e jashtëzakonshme e KGJK-së lidhur me masat e gjyqësorit rreth situatës me pandeminë COVID-19, 12 mars 2020, Prishtinë; https://www.gjyqesori-rks.org/2020/03/12/diskutohen-masat-e-gjyqesorit-lidhur-me-situaten-aktuale-covid-19/?fbclid=IwAR32dNp9igdfxAYp5nGFQEqCB4NT-fLL5ZgUfC48rg_9tEVDMoXSUkxGë.

22 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Krizës, KGJK mars 2020 - https://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/reports/69352_KGJK_Plani_veprimit_per_menaxhimin_krizes.pdf?fbclid=IwAR1KALMcyqYJlpEB9lan1LKjdOgSUnZ1ë8_j1ZUxu9to94y4zysEsDacQB4.

23 Shënim: Kërkesë ndaj KGJK-së lidhur me të dhënat që rrezikojnë parashkrimin, 3 qershor 2020.



Së fundmi, KGJK-ja në bashkëpunim me projektin e USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP) kanë hartuar një protokoll për fillimin gradual të mbajtjes së seancave gjyqësore online si një alternativë e cila do të mundësonte mbajtjen e seancave dhe procedimin e rasteve.²⁴ Sidoqoftë, përkundër faktit që janë mbajtur disa seanca, mbajtja e tyre online ende nuk ka arritur të funksionalizohet, kur kemi parasysh edhe kompleksitetin që ngërthen mbajtja e një seance në formë të tillë.

Puna me staf të reduktuar dhe mosmbajtja e seancave gjyqësore për shkak të situatës së krijuar me COVID-19, ka pasur efekt të theksuar mbi efikasitetin e gjykatës. E gjithë kjo ka rezultuar me zvarritje të proceseve gjyqësore, tejzgjatje të gjykimeve dhe parashkrim të rasteve.

2.1 Shtyrja dhe mosmbajtja e seancave gjyqësore

Shtyrja e seancave gjyqësore vazhdon të jetë e pranishme në të gjitha gjykatat themelore të Kosovës. Gjatë periudhës dyvjeçare të monitorimit të Organizatës Çohu! janë identifikuar **227 shtyrje të seancave gjyqësore**, ndërsa vetëm gjatë periudhës tetor 2019 – gusht 2020 nga **371** seanca të monitoruara, janë identifikuar **113 shtyrje të seancave gjyqësore**.

Arsyet e mosmbajtjes dhe shtyrjes së seancave gjyqësore vazhdojnë të jenë të njëjta vetëm se, ndryshe nga viti paraprak, nga muaji mars 2020 seancat po vazhdojnë të shtyhen për shkak të pandemisë COVID-19. Në gjykata dhe prokurori një kohë të gjatë janë trajtuar vetëm lëndët e karakterit urgjent dhe disa lëndë të tjera me rregullat e parapara, ndërsa janë

duke u bërë përpjekje për kalimin e mbajtjes së seancave në platformën online.

Gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, janë identifikuar raste të konsiderueshme të mosmbajtjes dhe shtyrjes së seancave gjyqësore për shkak të pandemisë COVID-19.²⁵ Shtyrja e këtyre rasteve kishte ardhur si pasojë e infektimit të prokurorëve, gjyqtarëve por edhe si pasojë e reduktimit të stafit në institucionet e drejtësisë. Reduktimi i stafit kishte ardhur si rezultat i vendimeve të KGJK-së dhe KPK-së me arsyetimin e uljes së rrezikut të shpërndarjes së virusit COVID-19.

Mosmbajtja dhe shtyrja e seancave për shkak të pandemisë bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në veçanti sa i përket të drejtave të palëve në një proces gjyqësor. Në Kushtetutë shprehimisht thuhet *“Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash”*²⁶

Të drejtat e palëve për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme, të drejtat e të akuzuarve të garantuara me Kushtetutën e vendit si dhe me konventa ndërkombëtare vazhdojnë të shkelen nga institucionet e drejtësisë në vendin tonë. Si pasojë e kësaj, qytetarët vazhdojnë të ballafaqohen me drejtësi joefikase dhe shkelje të drejtave të tyre, ndër të cilat është e drejta për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm.

24 Me shumë në: <https://www.gjyqesori-rks.org/2020/09/09/komunikate-8/>.

25 Shënim: Në GJTH Prishtinë, rasti PS.nr.17/20 me datën 16 korrik 2020 është shtyrë për shkak të pandemisë COVID-19. Raste të tjera të shtyrjes për arsye të njëjtë kanë ndodhur edhe në GJTH në Gjakovë, rasti Pkr.nr.11/20 është shtyrë më 30 qershor 2020. Në GJTH Prizren, rasti Pkr.nr. 14/19 me datën 6 korrik 2020 po ashtu është shtyrë për shkak të pandemisë.

26 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 56, par.2: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Gjatë periudhës dyvjeçare
të monitorimit janë
identifikuar

227

shtyrje të seancave
gjyqësore



ndërsa vetëm gjatë periudhës tetor 2019 – gusht 2020 nga

371 seanca të monitoruara

Janë identifikuar

113

shtyrje të seancave
gjyqësore

2.2 Dukuria e parashkrimit të lëndëve

Parashkrimi apo vjetërsimi është ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës penale. Parashkrimi si institut i së drejtës pamundëson ndjekjen penale si dhe ekzekutimin e sanksionit penal ndaj kryesve pas kalimit të afatit të përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Dukuria e parashkrimit është ndër problematikat e shumta të cilat e karakterizojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë. Arsyeet e parashkrimit janë të ndryshme, qoftë për shkaqe dhe pengesa objektive, qoftë për fajin e prokurorëve dhe gjykatësve si pasojë e neglizhencës qoftë të qëllimshme.

Periudha pandemike COVID-19 me të cilën po ballafaqohet bota ka pasur pasojat e saj edhe në Kosovë, gjithsesi edhe në sistemin e drejtësisë. Njëra nga

pasojat më të theksuara është edhe parashkrimi i lëndëve në gjykata themelore si dhe rreziku i parashkrimit të shumë lëndëve të tjera.

Nga të dhënat që i ka siguruar Preportri i cili operon në kuadër të Organizatës Çohu! rezultojnë se në gjykatat e Kosovës deri në fund të vitit 2020 ka rrezik të parashkruhen 492 lëndë – 442 prej tyre i përkasin parashkrimit absolut dhe 49 parashkrimit relativ.²⁷

Të dhënat janë siguruar vetëm për gjykatat themelore në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan dhe Pejë. Në anën tjetër, gjykatat themelore në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë përkundër insistimit të Organizatës ÇOHU! nuk kanë dërguar të dhënat për rastet e parashkrimit dhe ato që rrezikojnë të parashkruhen. Gjykata Themelore në Prizren ka sugjeruar që të dhënat për këtë gjykatë t'i kërkojmë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të cilit po ashtu kanë refuzuar të kthejnë përgjigje për rastet të cilat rrezikohen të parashkruhen deri në fund të vitit për shkak të pandemisë.





Gjykata	Parashkrim absolut	Parashkrim relativ	Gjithsej
 Ferizaj	232	x	232
 Gjakovë	45	x	45
 Gjilan	140	26	166
 Pejë	49	x	49

Tabela 3: Rastet e rrezikuara nga parashkrimi deri në fund të vitit 2020

²⁷ "Qindra lëndë mund të parashkruhen deri në fund të vitit", Preportri, korrik 2020 - http://preportr.cohu.org/repository/docs/09_-_Preportr_-_No_35_-_Parashkrimi_-_04_466857.pdf



Në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2019, në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar **25,909 lëndë penale.**

Gjatë monitorimit të gjykatave, Organizata ÇOHU! për periudhën 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019 ka hasur 9 raste të parashkrimit në GJTH në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Prizren dhe Pejë.²⁸

Për periudhën e monitorimit 1 tetor 2019 – 1 gusht 2020 janë identifikuar 5 raste të parashkrimit në GJTH në Prishtinë²⁹ dhe Prizren³⁰.

Në GJTH në Prishtinë gjatë periudhës së pandemisë, konkretisht në muajin maj 2020, rasti ndaj Sami Lushtakut, ku ai së bashku me Ismet Haxhën dhe Sahit Jasharin akuzohej se ishte arratisur nga QKUK-ja, ka rezultuar me parashkrim absolut. Rasti i Sami Lushtakut llogaritet si një nga rastet e profilit të lartë. Në këtë rast ishin të përfshirë edhe persona të tjerë me pozita shtetërore, oficerët korrektues Bashkim Dervisholli dhe Valon Behramaj dhe Argjend Behramaj, si dhe drejtori i Qendrës së Paraburgimit të Prishtinës, Emrush Thaçi. Të akuzuar po ashtu ishin dhe Nexhip Shatri dhe i ndjeri Sami Gjoka.³¹

Gjykata Themelore në Prizren ka shpallur aktgjykim refuzues për piken 3 të aktakuzës ndaj ish-drejtorit të arsimit në Komunën e Prizrenit Nexhat Çoçaj, ndërsa për pika të tjera të aktakuzës Nexhat Çoçaj së bashku me të akuzuarit Bekim Thaqi dhe Bedri Çeku janë liruar.

Gjyqësori i Kosovës posedon një shifër alarmante të rasteve të vjetërsuara ndër vite. Duke u bazuar në të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2019, në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar 25,909 lëndë penale. Gjatë kësaj periudhe janë parashkruar edhe lëndët që lidhen me korrupsionin. Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës ÇOHU! dhe në të dhënat e KGJK-së, vetëm gjatë viteve 2013 – 2018 në gjykatat e Kosovës janë vjetërsuar 58 lëndë kundër korrupsionit. Prej tyre, 8 në aspektin relativ dhe 50 në aspektin absolut.

Deri më tani institucionet e vendit nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për parandalimin apo luftimin e trendit të parashkrimit të lëndëve. Sidoqoftë, i vetmi ndryshim që është bërë pas plotësimit dhe ndryshimit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është zgjatja e afateve ligjore të parashkrimit.

Me anë ta parashkrimit, Gjyqësori në Kosovë në njërin anë vazhdon t'i amnistojë kryesit e veprave penale ndërsa në anën tjetër vazhdon me shkeljen e të drejtave të palëve të dëmtuara në procedurë.

Kjo dukuri e vjetërsimit apo parashkrimit të lëndëve përveç që vazhdon të rezultojë me mungesë të rezultateve të gjykatave dhe prokurorive, ajo vazhdon ta thellojë edhe humbjen e besimit të qytetarëve në një sistem të drejtë, të pavarur dhe me integritet.

28 “Qasja në Drejtësi”, Organizata Çohul, nëntor 2019- http://www.cohu.org/repository/docs/19_-_QASJA_N%C3%8B_DREJT%C3%8BSI_-_ALB_-_07_242950.pdf

29 GJTH në Prishtinë, Rasti me numër të lëndës Pkr.nr. 185/18. Më 14 shkurt 2020 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarve E.M dhe N.H për shkak të arritjes së parashkrimit absolut për veprat penale të korrupsionit.
GJTH në Prishtinë, Rasti me numër të lëndës Pkr.nr. 325/18. Më 22 nëntor 2019 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit H.T për shkak të arritjes së parashkrimit absolut për veprat penale të korrupsionit.
GJTH në Prishtinë, Rasti me numër të lëndës Pkr.nr. 685/18. Më 22 maj 2020 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarve S.L, I.H, dhe S.J, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të veprës penale.

30 GJTH në Prizren, Rasti me numër të lëndës Pkr.nr. 26/19. Më 22 janar 2020 është veçuar dhe pushuar procedura ndaj R.M për shkak të arritjes së parashkrimit relative për veprën penale të korrupsionit.
GJTH në Prizren, Rasti me numër të lëndës Pkr.nr. 66/19. Më 2 korrik 2020 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit N.Ç për shkak të arritjes së parashkrimit absolut për veprën penale të korrupsionit.

31 GJTH në Prishtinë, Rasti me numër të lëndës Pkr.nr. 685/18. Më 22 maj 2020 është shpallur aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarve S.L, I.H, dhe S.J, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të veprës penale.



3. VONESAT NË FILLIMIN E SEANCAVE GJYQËSORE

Duke u bazuar në gjetjet e organizatës Çohu! nga gjithsej **371** seancat e monitoruara për periudhën shtator 2019 – gusht 2020, **38** prej tyre kanë filluar me vonesë. Vonesat e identifikuar në monitorim janë vetëm ato të cilat përfshijnë fillimin me mbi 15 minuta vonesë të seancës. Vonesat e inkorporuara në raport sillshin nga 15 deri në 50 minuta. Vonesa e trupit gjykues dhe e prokurorëve janë ndër arsyet më të shpeshta për vonesat e fillimit të seancave.

Duke u bazuar po në gjetjet e Organizatës Çohu! nga gjithsej **38** seancat e filluara me vonesë, në **14** seanca arsye e fillimit me vonesë ishte vonesa e trupit gjykues në gjykatat themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë.³²

Vonesa e prokurorit gjithashtu është ndër arsyet e fillimit të seancave gjyqësore me vonesë. Sipas gjetjeve tona, **6** seanca kishin filluar me vonesë për shkak të vonesës së prokurorëve. Rastet e tilla të vonesave janë identifikuar në gjykatat themelore në Prishtinë, Prizren e Gjiilan.³³

Gjetjet e monitorimit kanë identifikuar edhe 4 vonesa të të akuzuarve,³⁴ 4 vonesa të mbrojtësve³⁵, 1 vonesë të dëshmitarit³⁶ dhe 7 vonesa të fillimit të shqyrtimit gjyqësor për shkaqe të tjera³⁷.

-
- 32 GJTH në Prishtinë: Pkr.nr.305/16 (14 janar 2019), Pkr.nr. 325/18 (21 nëntor 2019), Pkr.nr 185/18 (14 shkurt 2020), Pkr.nr. 305/16 (26 shkurt 2020), Pkr.nr. 355/17 (21 nëntor 2019), Pkr.nr. 629/14 (31 janar 2020), GJTH në Prizren: Pkr.nr. 30/19 (2 korrik 2020), GJTH Pejë: Pkr.nr. 26/18 (8 korrik 2020), GJTH në Gjiilan: Pkr.nr.93/19 (13 janar 2020), Pkr.nr. 160/19 (23 dhjetor 2019), Pkr.nr. 39/19 (3 dhjetor 2019), GJTH në Gjakovë: Pkr.nr. 15/19 (4 tetor 2019), Pkr.nr. 19/18 (18 tetor 2019), GJTH në Ferizaj: Pkr.nr. 15/19 (25 nëntor 2019).
- 33 GJTH në Prishtinë: Pkr.nr. 371/17 (4 tetor 2019), GJTH në Prizren: Pkr.nr.28/19 (14 janar 2020), Pkr.nr. 42/19 (27 janar 2020), Pkr.nr. 45/19 (14 janar 2020), Pkr.nr. 39/19 (11 nëntor 2019) GJTH në Gjiilan: Pkr.nr. 37/19 (9 dhjetor 2019).
- 34 GJTH në Gjiilan: Pkr.nr. 160/19 (14 nëntor 2020), GJTH në Gjakovë: Pkr.nr.64/18 (8 nëntor 2019), Pkr.nr.64/18 (29 qershor 2020) GJTH në Prizren: Pkr.nr. 1/20 (19 shkurt 2020).
- 35 GJTH në Prishtinë: Pkr.nr. 204/18 (10 tetor 2019), Pkr.nr. 519/13 (5 shkurt 2020), Pkr.nr. 230/18 (16 janar 2020), GJTH në Gjiilan: Pkr.nr. 81/19 (6 shkurt 2020),
- 36 GJTH në Ferizaj: Pkr.nr. 15/19 (19 nëntor 2019)
- 37 GJTH në Prishtinë: Pkr.nr. 610/16 (20 nëntor 2019), Pkr.nr. 206/18 (24 tetor 2019) GJTH në Prizren: Pkr.nr. 87/18 (26 shtator 2019), Pkr.nr. 54/19 (9 tetor 2019), Pkr.nr. 22/19 (6 dhjetor 2019), Pkr.nr. 54/19 (9 tetor 2019), Pkr.nr. 22/19 (6 dhjetor 2019 dhe 24 janar 2020), GJTH në Gjiilan: Pkr.nr. 238/18 (10 shkurt 2020), Pkr.nr. 93/19 (12 dhjetor 2019), GJTH në Ferizaj: Pkr.nr. 204/17 (12 dhjetor 2019)

	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e vonesës
1	Prishtinë	PKR.nr.305/16	14.01.2019	Trupi Gjykses
2	Prizren	PKR-30/19	02.07.2020	Trupi gjykses
3	Pejë	PKR-26/18	08.07.2020	Trupi gjykses
4	Gjilan	PKR.nr.93/19	13.01.2020	Trupi gjykses
5	Prishtinë	PKR.nr.325/18	21.11.2019	Trupi Gjykses
6	Prishtinë	PKR.nr.185/18	14.02.2020	Trupi Gjykses
7	Gjilan	PKR.nr.160/19	23.12.2019	Trupi gjykses
8	Gjilan	PKR.nr.39/19	03.12.2019	Trupi gjykses
9	Ferizaj	PKR.nr.15/19	25.11.2019	Trupi gjykses
10	Prishtinë	PKR.nr.305/16	26.02.2020	Trupi Gjykses
11	Gjakovë	PKR-15/19	04.10.2019	Trupi Gjykses
12	Gjakovë	PKR-19/18	18.10.2019	Trupi Gjykses
13	Prishtinë	PKR.nr.355/17	21.11.2019	Trupi Gjykses
14	Prishtinë	PKR.nr.629/14	31.01.2020	Trupi Gjykses
15	Prizren	PKR-28/19	14.01.2020	Prokurori ³⁸
16	Prizren	PKR-42/19	27.01.2020	Prokurori ³⁹
17	Prizren	PKR-45/19	14.01.2020	Prokurori ⁴⁰
18	Prizren	PKR-39/19	11.11.2019	Prokurori ⁴¹
19	Gjilan	PKR.nr.37/19	09.12.2019	Prokurori ⁴²

38 Shënim: Sipas komenteve të KPK-së, duke u bazuar në procesverbalin gjyqësor, Prokurori i rastit ka prezantuar në shqyrtimin gjyqësor mirëpo si pasojë e mungesës së dëshmitarëve seanca është shtyrë për një datë tjetër.

39 Sipas komenteve të KPK-së, duke u bazuar në procesverbalin gjyqësor, Prokurori i rastit ka prezantuar në seancë dhe shqyrtimi gjyqësor është mbajtur.

40 Sipas komenteve të KPK-së, duke u bazuar në procesverbalin gjyqësor, Prokurori i rastit është vonuar në shqyrtim gjyqësor, pasi që ka qenë i angazhuar në kohën e njëjtë në shqyrtim gjyqësor të rastit P.nr.113/19.

41 Sipas komenteve të KPK-së, duke u bazuar në procesverbalin gjyqësor, rezulton se Prokurori i Shtetit ka prezantuar dhe seanca është mbajtur.

42 KPK, ka konfirmuar shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të prokurorit. Arsyeja e shtyrjes së seancës ka qenë vizita studimore e prokurores në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e vonesës
19	Prishtinë	PKR.nr.371/17	04.10.2019	Prokurori
20	Gjilan	PKR.nr.160/19	14.11.2020	Akuzuari
21	Gjakovë	PKR-64/18	08.11.2019	Akuzuari
22	Prizren	PKR-1/20	19.02.2020	Akuzuari
23	Gjakovë	PKR-64/18	29.06.2020	Akuzuari
24	Prishtinë	PKR.nr. 204/18	10.10.2019	Avokati
25	Prishtinë	PKR.nr.519/13	05.02.2020	Avokati
26	Prishtinë	PKR.nr.230/18	16.01.2020	Avokatet
27	Gjilan	PKR.nr.81/19	06.02.2020	Avokati, prokurori
28	Ferizaj	PKR.nr.15/19	19.11.2019	Dëshmitari
29	Prishtinë	PKR.nr.610/16	20.11.2019	Shkaqe të tjera
30	Prizren	PKR-87/18	26.09.2019	Shkaqe të tjera
31	Prizren	PKR-54/19	09.10.2019	Shkaqe të tjera
32	Prizren	PKR-22/19	06.12.2019	Shkaqe të tjera
33	Prizren	PKR-22/19	24.01.2020	Shkaqe të tjera
34	Gjilan	PKR.nr.238/18	10.02.2020	Shkaqe të tjera
35	Gjilan	PKR.nr.93/19	12.12.2019	Shkaqe të tjera
36	Prishtinë	PKR.nr.206/18	24.10.2019	Shkaqe të tjera
37	Ferizaj	PKR.nr.204/17	12.12.2019	Shkaqe të tjera

Tabela 4: Rastet e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore

Përveç zvarritjes së shqyrtimeve, vonesat në fillim të shqyrtimeve gjyqësore rrezikojnë efikasitetin dhe besueshmërinë ndaj gjykatave. Gjykatat themelore në Kosovë vazhdojnë të jenë të ngarkuara me numër të madh të lëndëve dhe shfaqin efikasitet të dobët.

3.1 Ndërprerja dhe shtyrja e seancave gjyqësore

Neni 312 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parasheh tërësi të rregullave të cilat mundësojnë zgjidhjen e çështjeve penale me efikasitet dhe efektivitet. Organizata Çohu! ka identifikuar se këto rregulla nuk respektohen gjithmonë nga organet përkatëse.

Sipas dispozitës 312 të Kodit të Procedurës Penale, afati 8-ditor duhet të jetë i respektueshëm si afat në rastet kur shqyrtimi gjyqësor ndërpritet për pushim për shkak të kalimit të orarit të punës, për të lejuar një kohë të shkurtër që të sigurohet ndonjë provë apo edhe për përgatitjen e akuzës apo mbrojtjes.⁴³ Pra, ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor si rregull bëhet për kohë të shkurtër.

Monitorimi i Organizatës Çohu! ka identifikuar raste të rralla kur është aplikuar dhe është respektuar ky afat 8-ditor. Gjykatat themelore në Kosovë më shumë kishin vendosur ta aplikojnë paragrafin pasues, i cili ka të bëjë me mosrespektimin e afatit 8-ditor dhe kërkon aplikimin e nenit paraprak të Kodit të Procedurës Penale, gjegjësisht nenit 311.⁴⁴

Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës Çohu! në gjykatat e monitoruara për periudhën shtator 2019 – gusht 2020 janë ndërprerë 15 seanca gjyqësore, për arsyt të cilat përmenden në Nenin 312 par. 1, me ç’rast seancat e radhës nga ndërprerja e seancës gjyqësore ishin caktuar me vonesë, duke mos respektuar kështu afatin 8-ditor të paraparë me Nenin 312 të KPK-së.

Rastet e tilla të ndërprerjes së seancave janë identifikuar në gjykatat themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Gjakovë.⁴⁵

Shtyrja e seancave gjyqësore është problem tjetër i cili vazhdon të jetë i pranishëm në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.

Organizata Çohu! gjatë monitorimit të 371 seancave gjyqësore gjatë periudhës shtator 2019 – gusht 2020 ka identifikuar 113 shtyrje të seancave.

Ndër arsyt më të shpeshta të mosmbajtjes dhe shtyrjes së seancave në të gjitha gjykatat themelore kishte qenë mungesa e të akuzuarve dhe prokurorëve. Mungesa e trupit gjykues, mungesa e mbrojtësve, dëshmitarëve, përfaqësuesve, pjesëmarrja në seminare dhe mosdorëzimi i shkresave të lëndës për palët kishin qenë arsyt e shtyrjes së seancave.

Shkaqet e mungesës së prokurorëve,⁴⁶ gjyqtarëve,⁴⁷ të

43 Kodi i Procedurës Penale, paragrafi 3 i nenit 312: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

44 Paragrafi 3 i nenit 312 i Kodit të Procedurës Penale: Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdojë para të njëjtit trup gjykues, ose kur ndërprerja e tij zgjat më tepër se tetë (8) ditë, atëherë zbatohen dispozitat nga neni 311 i këtij Kodi. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

45 GjTH në Prizren: Pkr.nr. 87/18(26 shtator 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 21 nëntor 2019), Pkr.nr. 65/19(21 tetor 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 20 nëntor 2019), Pkr.nr.45/19(3 tetor 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 1 dhe 14 nëntor 2019), Pkr.nr. 22/19 (6 dhjetor 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 24 janar 2020), Pkr.nr. 66/19 (20 dhjetor 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 24 janar 2020), Pkr.nr.13/19 (4 nëntor 2019, pas ndërprerjes seanca u caktua për 19 shkurt 2020), Pkr.nr. 26/19 (20 janar 2020, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 27 shkurt 2020), Pkr.nr. 22/19 (21 janar 2020, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 2 mars 2020), Pkr.nr. 44/16 (5 shkurt 2020, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 17 mars 2020), Pkr.nr.45/19 (14 janar 2020, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 7 shkurt 2020), Pkr.nr. 30/19 (13 shkurt 2020, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 20 mars 2020), GjTH në Gjakovë: Pkr.nr. 64/18(24 dhjetor 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës u caktua për 3 shkurt 2020), GjTH në Pejë: Pkr.nr. 58/18(23 dhjetor 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës është shtyrë për kohë të pacaktuar), GjTH në Prishtinë: Pkr.nr. 748/19 (22 tetor 2019, pas ndërprerjes seanca e radhës është shtyrë për kohë të pacaktuar), Pkr.nr. 40/18 (26 shkurt 2020, pas ndërprerjes seanca e radhës është shtyrë për kohë të pacaktuar).

46 Shënim: Mungesa e prokurorit Ali Uka ishte shkak i shtyrjes së seancës të datës 10 dhjetor 2019 në GjTH në Pejë. Gjykata konstatoi se prokuroria ishte njoftuar me kohë dhe ftesë të rregullt, por prokurori Uka ka njoftuar gjykatën se nuk mund të marrë pjesë në seancë për shkak të angazhimeve të tjera. Për arsye të njëjta është shtyrë seanca në GjTH në Prishtinë, me nr. të rastit PKR.nr. 164-17, prokurorja Dulina Halimi kishte njoftuar gjykatën se është e angazhuar në një rast tjetër në gjykatë. Gjithashtu në GjTH në Gjilan, rasti me nr. Pkr.nr.145/19, me datën 17 janar 2020, është shtyrë për shkak të mungesës së prokurorit Isufi i cili kishte qenë i angazhuar në një seancë tjetër.

47 Shënim: Në GjTH në Prishtinë, më 26 nëntor 2019, rasti me nr. Pkr.nr.164.17 është shtyrë për shkak të trupit gjykues. Për arsye të njëjta është shtyrë dhe rasti Pkr.nr.305/16 më 26 shkurt 2020 në Prishtinë, rasti Pkr.nr. 45/19 më 7 shkurt 2020 në GjTH në Prizren, rasti Pkr.nr.174/19 më 5 shkurt 2020 në GjTH në Gjilan, rasti Pkr.nr. 114/17, më datë 4 dhjetor 2019 në GjTH në Ferizaj.



akuzuarve,⁴⁸ mbrojtësve,⁴⁹ dëshmitarëve⁵⁰ si dhe mosdorëzimi i shkresave tek palët janë ndër arsytet më të ndryshme të cilat kanë shkaktuar shtyrje të seancave, që si pasojë kanë prodhuar zvarritje të proceseve gjy-

qësore dhe mungesë të efikasitetit të gjyqësorit.

	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e shtyrjes
1	Prishtinë	PKR.nr.164-17	04.02.2020	Prokurori
2	Prishtinë	PKR.nr.157-17	18.10.2019	Prokurori
3	Prishtinë	PKR.nr.08-19	13.02.2020	Prokurori
4	Gjakovë	PKR.nr.19/18	07.10.2019	Prokurori
5	Prizren	PKR.nr.37/19	09.10.2019	Prokurori
6	Prizren	PKR.nr.26/19	10.10.2019	Prokurori ⁵¹
7	Prizren	PKR.nr.22/19	24.10.2019	Prokurori ⁵²
8	Gjakovë	PKR.nr.16/18	24.10.2019	Prokurori
9	Pejë	PKR.nr.25/18	10.12.2019	Prokurori
10	Pejë	PKR.nr.25/18	21.01.2020	Prokurori
11	Gjakovë	PKR.nr.64/18	03.02.2020	Prokurori, akuzuari

48 Shënim: Në GJTH në Prishtinë rasti PKR.nr.206-18, më 19 shkurt 2020 është shtyrë për shkak të të akuzuarve. Për shkaqe të të akuzuarve është shtyrë dhe rasti PKR.nr.13/19, më 11 dhjetor 2019 në GJTH Prizren, rasti PKR-19/18, me datën 20 shkurt 2020 në GJTH në Gjakovë, rasti PKR.nr.160/19 më 14 nëntor 2020 në GJTH në Gjilan.

49 Shënim: Në GJTH në Prishtinë, rasti PKR.nr. 325/18, më 1 nëntor 2019 është shtyrë për shkak mungesës së mbrojtësit. Për shkaqe të mungesës së mbrojtësit është shtyrë dhe rasti Pkr.nr. 15/19 më 4 tetor 2019 në GJTH në Gjakovë, rasti Pkr.nr. 61/19 më 28 korrik 2020 në GJTH në Prizren, rasti Pkr.nr. 58/19 më 13 nëntor 2019 në GJTH në Gjilan.

50 Shënim: Në GJTH në Prishtinë rasti Pkr.nr. 306/16, më 26 shkurt 2020 është shtyrë për shkak të mungesës së dëshmitarit. Për shkaqe të mungesës së dëshmitarëve është shtyrë dhe rasti Pkr.nr. 15/16 më 19 nëntor 2019 në GJTH në Ferizaj, rasti Pkr.nr. 28/19 më 14 janar 2020 në GJTH në Prizren.

51 Shënim: Në bazë të komenteve të KPK-së, bazuar në procesverbalin gjyqësor, prokurori ka prezantuar dhe seanca gjyqësore është mbajtur.

52 Shënim: KPK ka konfirmuar shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të prokurorit, arsyeja e shtyrjes ishte takimi i prokurorëve me familjarët e të ndjerit Dehari.

	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e shtyrjes
12	Prizren	PKR-1/20	19.02.2020	Prokurori ⁵³
13	Gjakovë	PKR.nr.26/19	27.02.2020	Prokurori
14	Prizren	PKR.nr.89/19	14.07.2020	Prokurori ⁵⁴
15	Gjilan	PKR.nr.145/19	17.01.2020	Prokurori
16	Gjilan	PKR.nr.93/19	21.01.2020	Prokurori
17	Prishtinë	PKR.nr.167/17	15.10.2019	Prokurori
18	Prizren	PKR.nr.37/19	12.12.2019	Prokurori ⁵⁵
19	Gjakovë	PKR.nr.64/18	16.12.2019	Prokurori
20	Prizren	PKR.nr.44/16	17.12.2019	Prokurori ⁵⁶
21	Pejë	PKR.nr. 25/18	21.01.2020	Prokurori
22	Prishtinë	PKR.nr.164-17	26.11.2019	Trupi Gjykses
23	Prishtinë	PKR.nr.305-16	26.02.2020	Trupi Gjykses, dëshmitarët.
24	Prizren	PKR.nr.61/19	26.11.2019	Trupi Gjykses
25	Prizren	PKR.nr.44/16	01.11.2019	Trupi gjykses
26	Prizren	PKR.nr.61/19	26.11.2019	Trupi gjykses

53 Sipas komenteve të KPK-së, në bazë të procesverbalit rezulton se në shqyrtim gjyqësor ka prezantuar Prokurori i Shtetit, nuk është konstatuar vonesa në procesverbal dhe se shqyrtimi është mbajtur.

54 Sipas komenteve të KPK-së, në bazë të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, rezulton se Prokurori i Shtetit, nuk ka prezantuar në shqyrtim gjyqësor pasi që ka qenë i angazhuar në kohën e njëjtë në një shqyrtim tjetër gjyqësor.

55 Sipas komenteve të KPK-së, në bazë të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, rezulton se në shqyrtim gjyqësor nuk ka prezantuar Prokurori i Shtetit, mirëpo Prokurori i Shtetit pranë gjykatës ka parashtruar kërkesë me shkrim për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor pasi që Prokurorja e çështjes për shkaqe shëndetësore nga data 11.12.2019, nuk ka prezantuar në punë dhe se ka qenë e shtrirë në spital.

56 Ibid



	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e shtyrjes
27	Prizren	PKR.nr.26/19	03.12.2019	Trupi gjykues
28	Prizren	P.nr.60/19	05.12.2019	Trupi gjykues
29	Prizren	PKR.nr.45/19	07.02.2020	Trupi gjykues
30	Gjilan	PKR.nr.174/19	05.02.2020	Trupi gjykues
31	Gjilan	PKR.81/19	06.12.2019	Trupi gjykues
32	Gjilan	PKR.129/18	03.12.2019	Trupi gjykues
33	Ferizaj	PKR.nr.114/17	04.12.2019	Trupi gjykues
34	Prishtinë	PKR.nr.305-16	03.10.2019	Akuzuari
35	Prishtinë	PS.nr.27-19	03.02.2020	Akuzuari
36	Prishtinë	PKR.nr.206-18	19.02.2020	Akuzuari
37	Prishtinë	PKR.nr. 754-16	17.10.2019	Akuzuari
38	Prishtinë	PS.nr.24.19	13.12.2019	Akuzuari
39	Prishtinë	PS.nr.24.19	24.01.2020	Akuzuari
40	Prishtinë	PKR.nr.16-18	27.09.2019	Akuzuari
41	Prishtinë	PKR.nr.230-18	23.12.2019	Akuzuari
42	Prishtinë	PKR.nr. 314-16	15.10.2019	Akuzuari
43	Prizren	PKR.nr.65/19	14.10.2019	Akuzuari
44	Prizren	PKR.nr.89/19	12.11.2019	Akuzuari

	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e shtyrjes
45	Prizren	PKR.nr.13/19	11.12.2019	Akuzuari
46	Prizren	PKR.nr.113/19	14.01.2020	Akuzuari
47	Gjakovë	PKR-19/18	20.02.2020	Akuzuari
48	Gjakovë	P.nr.492/19	18.06.2020	Akuzuari
49	Prizren	PKR.nr.57/19	07.06.2020	Akuzuari
50	Prizren	PKR.nr.26/18	08.07.2020	Akuzuari
51	Prizren	PKR.nr.75/19	16.07.2020	Akuzuari
52	Prizren	PKR.nr.1/20	07.08.2020	Akuzuari
53	Gjilan	PKR.129/18	10.12.2019	Akuzuari
54	Gjilan	PKR.nr.160/19	14.11.2020	Akuzuari
55	Prishtinë	PKR.nr.610-16	27.09.2019	Avokati
56	Prishtinë	PKR.nr.325-18	01.11.2019	Avokati
57	Prishtinë	PKR.nr.230-18	16.01.2020	Avokati
58	Gjakovë	PKR.nr.15/19	04.10.2019	Avokati
59	Prizren	PKR.nr.75/19	19.11.2019	Avokati, akuzuari
60	Prizren	PKR.nr.45/19	04.12.2019	Avokati, akuzuari
61	Prizren	PKR.nr.61/19	28.07.2020	Avokati
62	Gjilan	PKR.nr.58/19	13.11.2019	Avokati



	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e shtyrjes
63	Prishtinë	PKR.nr.355-17	30.09.2019	Dëshmitari
64	Gjakovë	PKR.nr.14/19	17.10.2019	Dëshmitari
65	Prizren	PKR.nr.28/19	14.01.2020	Dëshmitari
66	Gjilan	PKR.nr.32/19	31.01.2020	Dëshmitarët
67	Prishtinë	PKR.nr.305-16	26.02.2020	Dëshmitari
68	Ferizaj	PKR.nr.15/19	19.11.2019	Dëshmitari
69	Prizren	PKR.nr.93/19	14.02.2020	Dëmtuari
70	Prizren	PKR.nr.66/19	24.01.2020	Përfaqësuesi
71	Prizren	PKR.nr.75/19	27.01.2020	Përfaqësuesi
72	Prizren	PKR.nr.14/19	31.01.2020	Përfaqësuesi
73	Prizren	PKR.nr.26/19	02.07.2020	Përfaqësuesi
74	Prizren	PKR.nr.110/19	03.07.2020	Përfaqësuesi
75	Prizren	PKR.nr.29/20	15.07.2020	Përfaqësuesi
76	Prizren	PKR.nr.22/19	16.07.2020	Përfaqësuesi
77	Prishtinë	PKR.nr.610-16	18.06.2020	COVID-19
78	Prishtinë	PS.nr.17-20	15.07.2020	COVID-19
79	Prishtinë	PKR.nr. 297-19	14.07.2020	COVID-19
80	Prishtinë	PKR.nr.203-19	09.07.2020	COVID-19

	Gjykata	Nr. i lëndës	Data	Arsyet e shtyrjes
81	Prishtinë	PKR.nr. 164-17	09.07.2020	COVID-19
82	Prishtinë	PKR.nr.337-18	19.07.2020	COVID-19
83	Prishtinë	PKR.nr.206-19	13.07.2020	COVID-19
84	Prishtinë	PKR.nr.142-18	09.07.2010	COVID-19
85	Prizren	PKR.nr.111/19	22.07.2020	COVID-19
86	Gjakovë	PKR.nr.11/20	30.06.2020	COVID-19
87	Prizren	PKR.nr.14/19	06.07.2020	COVID-19
88	Prishtinë	PKR.nr.219-19	29.10.2019	Shkaqe të tjera
89	Prishtinë	PS.nr.24.19	18.02.2020	Shkaqe të tjera
90	Gjakovë	PKR.nr.11/20	19.06.2020	Shkaqe të tjera
91	Prizren	PKR.nr.37/19	09.10.2019	Shkaqe të tjera
92	Gjakovë	PKR.nr. 16/18	24.10.2019	Shkaqe të tjera
93	Gjilan	PKR.nr. 174/19	05.02.2020	Shkaqe të tjera
94	Gjilan	PKR.nr. 81/19	06.12.2019	Shkaqe të tjera
95	Gjilan	PKR.nr. 129/18	03.12.2019	Shkaqe të tjera
96	Ferizaj	PKR.nr. 114/17	04.12.2019	Shkaqe të tjera

Tabela 5: Rastet e shtyrjes së seancave në Gjykatat Themelore



4. SHKELJA E AFATEVE LIGJORE

Shkelja e afateve ligjore vazhdon të jetë gjetje tjetër e monitorimit të Organizatës ÇOHU! ndër vite. Vonesat dhe shtyrjet e caktimit dhe mbajtjes së seancave gjyqësore që kanë qenë pjesë e pothuajse çdo publikimi të Organizatës ÇOHU! sa i përket monitorimit të seancave gjyqësore, kanë vazhduar të jenë ende problematike kur kemi parasysh pamundësitë e mbajtjes së seancave gjyqësore për shkak të pandemisë COVID-19.

Organizata ÇOHU! ka identifikuar shkelje flagrante të afateve procedurale të një shqyrtimi në fazat e ndryshme procedurale, që përfshin periudhën deri në 1,520 ditë vonesë (mbi katër vjet) të mbajtjes së një shqyrtimi.

E gjithë kjo vonesë dhe shtyrje e seancave ka pasuar me shkelje të të drejtave të palëve në gjykim dhe me shkelje të parimeve të drejtësisë sa i përket mbarëvajtjes dhe ekonomizimit të gjykimit, gjykimit brenda kohës së arsyeshme, gjë që parashihet me instrumente ligjore vendore dhe ndërkombëtare.

Shtyrja e seancave ka ndodhur pothuajse në secilën fazë të procedurës – në shqyrtimin fillestar, dytësor dhe kryesor si dhe në përfundimin e një shqyrtimi gjyqësor.

4.1 Shkelja e afatit në shqyrtimin fillestar

Sipas Kodit të Procedurës Penale, nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë (aktakuzës), brenda afatit 30-ditor, përkatësisht 15-ditor (për rastet me paraburgim), gjykata duhet të caktojë dhe të mbajë shqyrtimin fillestar.⁵⁷ Monitorimi i Organizatës ÇOHU! ka identifikuar raste të shumta të mosrespektimit të këtij afati. Edhe pse obligimi i gjykatës ishte që seanca për rastet e tilla të caktohet menjëherë dhe të mbahet jo me larg se afati 30-ditor (15 ditë për rastet me paraburgim), Organizata ÇOHU! ka identifikuar shkelje të këtij afati për më shumë se 1,489 ditë.

Duke shkelur këtë afat, gjykata ka bërë shkelje të nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale si dhe shkelje të dispozitave të tjera lidhur me të drejtat elementare të njeriut të parapara me ligj, me kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare, pasi që gjykimi nuk është realizuar në kohë të arsyeshme.

Rastet me vonesa të mbajtjes së një shqyrtimi janë identifikuar pothuajse në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, mirëpo vonesat dhe shkeljet më të theksuara janë identifikuar në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Gjakovë.

57 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-123, neni 242, paragrafi 4 dhe 5: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.



Organizata ÇOHU! ka identifikuar shkelje flagrante të afateve procedurale të një shqyrtimi në fazat e ndryshme procedurale, që përfshinë periudhën deri në **1,520 ditë** vonesë (mbi katër vjet) të mbajtjes së një shqyrtimi.

Rasti më eklatant është identifikuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Edhe pse u pranua në gjykatë më 26 prill 2017, seanca fillestare nuk ishte caktuar/mbajtur deri më 25 qershor 2020, saktësisht 1,520 ditë pas pranimit të rastit në gjykatë.⁵⁸

Dy rastet e tjera janë ai i identifikuar në GJTH në Gjilan dhe rasti i monitoruar në GJTH në Gjakovë. Përderisa seanca nga rasti i parë ishte mbajtur me 419 ditë vonesë,⁵⁹ seanca tjetër në GJTH në Gjakovë ishte mbajtur me 751 ditë vonesë.⁶⁰

4.2 Shkelja e afatit në shqyrtimin dytësor

Shkelje të dispozitave procedurale janë identifikuar edhe gjatë procedimit të rasteve në shqyrtimin dytësor. Nevoja për mbajtjen e një shqyrtimi dytësor varet nga rasti dhe është në kompetencë të gjykatës mbajtja e një shqyrtimi të tillë.

Edhe për shqyrtimin e tillë janë paraparë afate të mbajtjes së tij, të cilat janë shkelur gjithashtu – gjithmonë sipas gjetjeve të Organizatës ÇOHU!

Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, seanca e shqyrtimit dytësor në rastet kur ajo caktohet për tu mbajtur, do të duhej të mbahej jo më herët se 30 ditë nga shqyrtimi i parë dhe jo më vonë se 40 ditë nga ai shqyrtim.

Megjithatë edhe ky afat, njëjtë si ai i shqyrtimit fillestar, është shkelur pothuajse nga të gjitha gjykatat. Sipas të dhënave të monitorimit, rasti me shkeljen me të theksuar, pra me vonesën më të gjatë të mbajtjes së shqyrtimit të tillë, është identifikuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Edhe pse shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 2 gusht 2019, ai dytësor i cili ishte dashur të mbahej jo më herët se 30 ditë dhe jo më vonë se 40 ditë, është mbajtur pas 341 ditësh, apo me 301 ditë vonesë.⁶¹

Dy rastet e tjera me vonesat më të theksuara është ai i monitoruar në GJTH në Ferizaj dhe tjetri në GJTH në Gjakovë. Për të dy rastet, kohëzgjatja e mbajtjes së

58 Shënim: GJTH në Prishtinë, Rasti PKR.nr.58-20, i pranuar në gjykatë më 26 prill 2017, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte caktuar më 25 qershor 2020.

59 Shënim: GJTH në Gjilan, rasti PKR.37/19, i pranuar në gjykatë më 16 dhjetor 2017, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 2 mars 2019.

60 Shënim: GJTH në Gjakovë, rasti PKR-64/18, i pranuar në gjykatë më 10 prill 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 31 maj 2018.

61 Shënim: GJTH në Prishtinë, rasti PKR.nr.142-18. Derisa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 9 gusht 2019, shqyrtimi dytësor ishte caktuar më 9 korrik 2020, 341 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar.



shqyrtimit dytësor kishte zgatur 217 ditë nga mbajtja e shqyrtimit fillestar, edhe pse seanca do të duhej të mbahej jo më herët se 30 ditë dhe jo më vonë se 40 ditë.⁶²

Raste të tilla të vonesave janë identifikuar pothuajse në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.

4.3 Shkelja e afatit në shqyrtimin kryesor dhe në përfundimin e tij

Shkelje të afateve procedurale ligjore janë identifikuar edhe në shqyrtimin kryesor dhe në përfundimin e tij. Sipas Kodit të Procedurës Penale, derisa shqyrtimi kryesor është paraparë të mbahet brenda një muaji (30 ditë) nga shqyrtimi dytësor,⁶³ shqyrtimi kryesor do të duhej të përfundonte brenda 90 ditëve, përkatësisht 120 ditëve prej seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor.⁶⁴

Sikurse në fazat e mëhershme të një shqyrtimi gjyqësor, shkelja e afateve ka qenë e theksuar edhe në mbajtjen dhe në përfundimin e një shqyrtimi kryesor. Sipas gjetjeve të Organizatës ÇOHU!, gjykatat themelore në Prizren, Ferizaj dhe Prishtinë janë gjykatat me vonesat më të theksuara të mbajtjes së shqyrtimit kryesor. Përderisa në GJTH në Prizren është evidentuar shkelja

deri në 1,041 ditë,⁶⁵ në GJTH në Ferizaj kishte vonesë deri në 479 ditë,⁶⁶ ndërsa në GJTH në Prishtinë vonesat e mbajtjes së një shqyrtimi gjyqësor kishin shkuar deri në 1,007 ditë.⁶⁷ Sa i përket përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i cili do të duhej të ndodhte brenda 90 ditëve, përkatësisht 120 ditëve prej seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor, janë identifikuar vonesa deri në pothuajse 100 ditë në rastet për të cilët është shpallur aktgjykimi.

Gjykatat themelore në Prizren dhe Prishtinë janë dy gjykatat me shkeljet e këtij afati. Përderisa në rastin e parë të identifikuar në GJTH në Prishtinë kishin kaluar gjithsej 192 ditë deri në shpalljen e aktgjykimit,⁶⁸ GJTH në Prizren kishte vendosur pas 186 ditëve nga fillimi i shqyrtimit kryesor.⁶⁹

Duke u bazuar në gjetjet e Organizatës ÇOHU!, shkelje të afateve lidhur me fazat e një seance gjyqësor (shqyrtimi fillestar, dytësor, shqyrtimi kryesor dhe përfundimi i një shqyrtimi), kishte pasur pothuajse në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.

Shkelja e afateve të tilla bie ndesh me parimet e drejtësisë sa i përket gjyqësorit të drejtë dhe brenda kohës të arsyeshme, të paraparë me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën e Kosovës si dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës si dhe Ligjit për Gjykatat.

Mosrespektimi i afateve të tilla vazhdon të shkaktojë mungesë të efikasitetit nga gjykatat ku për shkak të

62 Shënim: Rastet PKR.114/17 në GJTH në Ferizaj dhe ai PKR-64/18 në GJTH në Gjakovë. Derisa shqyrtimi fillestar i rastit PKR.114/17 në Ferizaj ishte mbajtur më 14 shkurt 2018, shqyrtimi dytësor ishte mbajtur më 23 shtator 2018. Shqyrtimi fillestar për rastin PKR-64/18 në GJTH në Gjakovë ishte mbajtur më 31 maj 2018, shqyrtimi dytësor ishte mbajtur më 3 janar 2019, 217 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

63 Shënim: Sipas KPPK-së, neni 285 paragrafi 2 lidhur me nenin 254 paragrafi 5, gjykatësi i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

64 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-123, neni 314 paragrafi 1.1 dhe 1.2: Një shqyrtim kryesor duhet të përfundojë brenda 90 dite, përkatësisht 120 ditëve prej seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

65 Shënim: Rasti PKR-66/19. Derisa shqyrtimi dytësor është mbajtur më 10 qershor 2015, shqyrtimi kryesor është mbajtur më 17 maj 2018, 1071 ditë nga mbajtja e shqyrtimit dytësor.

66 Shënim: Rasti PKR.114/17. Derisa shqyrtimi dytësor është mbajtur më 23 shtator 2018, shqyrtimi kryesor është mbajtur më 14 shkurt 2020, 509 ditë nga mbajtja e shqyrtimit dytësor.

67 Shënim: Rasti PKR.nr.08-19. Derisa shqyrtimi fillestar është mbajtur më 30 gusht 2016, shqyrtimi kryesor është mbajtur më 3 korrik 2019, 1,037 ditë nga mbajtja e shqyrtimit fillestar (shqyrtim dytësor nuk ka pasur në këtë rast).

68 Shënim: Rasti PKR.nr.242-18. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar më 24 maj 2019, aktgjykimi ishte shpallë më 28 janar 2020, 192 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin kohëzgjatjen e shqyrtimit kryesor prej 90 përkatësisht 120 ditësh, siç përcakton neni 314 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

69 Shënim: Rasti PKR-66/19. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar më 17 maj 2018, aktgjykimi ishte shpallë më 19 nëntor 2018, 186 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor.

vonesave dhe shkeljeve të tilla gjykatat vazhdojnë të kenë zvarritje në procedim të rasteve si dhe mungesë të rezultateve në trajtimin e rasteve të natyrave të ndryshme.

Edhe në publikimet e viteve paraprake Organizata ÇOHU! kishte vënë në pah rëndësinë e respektimit të këtyre afateve si dhe gjithashtu rëndësinë e të kuptuarit të arsyeve dhe shkaqeve të vërteta të vonesave dhe shkeljeve të tilla. Mirëpo, duke u bazuar në gjetjet e Organizatës ÇOHU!, KGJK-ja ende nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për adresimin e problemeve të tilla.

Është e rëndësishme që KGJK-ja të ndërmarrë masat e duhura për adresimin e problemeve të tilla, të cilat do të ndihmonin në rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe respektim të dispozitave ligjore vendore dhe ndërkombëtare.



Përderisa në GJTH në Prizren është evidentuar shkelja deri në 1,041 ditë, në GJTH në Ferizaj kishte vonesë deri në 479 ditë, ndërsa në GJTH në Prishtinë vonesat e mbajtjes së një shqyrtimi kryesor kishin shkuar deri në 1,007 ditë

5. NDËRRIMI I PROKURORËVE GJATË PËRFAQËSIMIT TË AKTAKUZAVE

Gjatë monitorimit sistematik të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, Organizata ÇOHU! ka identifikuar raste të shumta të ndërrimit të prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave në gjykata.

Rastet e ndërrimit të prokurorëve në gjykata themelore janë përcjellë me mungesë profesionale dhe me një përfaqësim dhe argumentim të dobët të aktakuzave.

Monitorimi i Organizatës Çohu!, gjatë periudhës së monitorimit tetor 2018 – gusht 2020 ka identifikuar 33 raste të ndërrimit të prokurorëve. Edhe pse ndërrimi i prokurorëve sipas Kodit të Procedurës Penale nuk përbën shkelje, gjatë monitorimit të seancave gjyqësore

është evidentuar se ndërrimi i prokurorëve po shkakton përfaqësim jo të denjë të aktakuzave. Si rrjedhojë e kësaj, kjo dukuri ka rezultuar me shkelje të të drejtave të të pandehurve si dhe shumë pasoja të tjera të cilat janë reflektuar në (mos)efikasitetin e gjyqësorit.

Gjatë monitorimit shtator 2019 – gusht 2020 janë identifikuar 5 raste të ndërrimit të prokurorëve në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë dhe Pejë.⁷⁰

Në këtë drejtim është vërejtur progres nga ana e gjyqësorit krahasuar me vitin e kaluar gjatë të cilit Organizata ÇOHU! ka identifikuar 28 raste të ndërrimit të prokurorëve të cilat janë shoqëruar me papërgatitje të prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave.⁷¹

70 Shënim: Në GJTH në Gjakovë, rasti Pkr.nr. 64/18, më 29 qershor 2020 është përfaqësuar nga prokurorja Florie Shamolli pasi e njëjta lëndë ishte përfaqësuar nga prokurori Atdhe Dema.

Në GJTH në Pejë, rastin Pkr.nr.25/18, e ka përfaqësuar prokurori Ali Uka ngase ndaj prokurorit të lëndës Ramiz Buzhala është caktuar masë disiplinore.

Rasti në fjalë fillimisht ka qenë i përfaqësuar nga prokurori i ndjerë Agron Matjani.

Në GJTH në Gjilan, rasti Pkr.nr. 172/18, më 14 janar 2020 është përfaqësuar nga prokurori Isuf Sadiku, në mungesë të prokurorit Agron Uka.

Në GJTH në Prishtinë, rasti Pkr.nr. 40/18, më 25 tetor 2019 është përfaqësuar nga prokurori Enver Krasniqi në mungesë të prokurores Florie Shamolli. Rasti 24/19 më 13 dhjetor 2019 është përfaqësuar nga prokurorja Fikrije Fejzullahu në mungesë të prokurores Merita Binja – Rugova.

71 "Qasja në Drejtësi", Organizata Çohu!, nëntor 2019 - http://www.cohu.org/repository/docs/19_-_QASJA_N%C3%8B_DREJT%C3%8BBSI_-_ALB_-_07_242950.pdf

Sidoqoftë, edhe pse është identifikuar progres i lehtë kundrejt vitit të kaluar, sistemi i drejtësisë ballafaqohet me papërgatitje të prokurorëve për përfaqësimin e aktakuzave dhe përfaqësim i dobët i prokurorisë për arsyet e ndryshme, dhe kjo vazhdon t'i kushtojë sistemit të drejtësisë me mungesë efikasiteti dhe rezultate të dobëta në luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Njëjtë si në vitin paraprak të raportimit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht mekanizmat disiplinorë dhe të performancës së KPK-së, vazhdon të ketë mungesë të rezultateve konkrete në ndëshkimin dhe disiplinimin e prokurorëve të cilët kanë rënë ndesh me rregullat etike, profesionale dhe ligjore. Ende mbeten të rralla rastet e inicimit dhe kompletimit të procedurave disiplinore dhe ndëshkuese ndaj prokurorëve për shkak të performancës së dobët dhe dështimit të aktakuzave të tyre.



Gjatë periudhës së monitorimit tetor 2018 – gusht 2020 janë identifikuar

33 raste

të ndërrimit të prokurorëve të cilat janë shoqëruar me papërgatitje të prokurorëve gjatë përfaqësimit të aktakuzave.

6. RASTET E PROFILIT TË LARTË – KORRUPSIONI I NIVELIT TË LARTË

Organizata ÇOHU! gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës me prioritet ka monitoruar rastet të cilat konsiderohen të profilit të lartë.

Pas krijimit të Prokurorisë Speciale është krijuar edhe Departamenti Special në GjTH në Prishtinë dhe në Gjykatën e Apelit. Këto departamente merren me trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të cilat ngriten nga Prokuroria Speciale.

Gjatë monitorimit shtator 2019 – gusht 2020 Organizata ÇOHU! ka identifikuar 16 raste të korrupsionit të nivelit të lartë të trajtuara nga gjykatat themelore në Prishtinë (Departamenti Special dhe Departamenti për Krime të Rënda)⁷², Pejë⁷³, Prizren⁷⁴, Gjakovë⁷⁵. Sipas të dhënave të monitorimit, në rastet e korrupsionit të lartë janë përfshirë personat nga profilet e ndryshme si deputetë, ministra, zv/ministra, kryetarë të komunave, kryetarë të gjykatave e të tjerë.

Trajtimi i lëndëve të korrupsionit të nivelit të lartë nga gjykatat është përcjellë me vonesa, ndërprerje dhe shtyrje të seancave si dhe shkelje të afateve ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Rasti Pkr.nr. 64/18, i cili trajtohet nga Gjykata Themelore në Gjakovë, ku të akuzuar janë Pal Lekaj, Ismet Isufi, Gani Rama dhe Veli Hajdaraga, ka pasur zvarritje të procesit gjyqësor. Seancat gjyqësore të këtij procesi ishin shtyrë 5 herë – 3 herë për shkak të prokurorit, 2 herë për shkak të gjykatësit, si dhe nga 1 herë për shkak të të akuzuarit dhe mbrojtësit të të akuzuarave. Po ashtu, në këtë rast nuk janë respektuar afatet ligjore lidhur me caktimin e shqyrtimit fillestar dhe atij të dytë.

Te rasti Pkr.nr. 25/18, i cili po trajtohet nga Gjykata Themelore në Pejë, ku i akuzuar është Haki Rugova, Organizata ÇOHU! ka evidentuar shkelje të afateve ligjore të caktimit të shqyrtimit fillestar prej 10 muajve si dhe të atij dytësor prej 2 muajve. Rasti po ashtu është karakter-

72 GjTH në Prishtinë: Rastet me nr. të lëndës: Pkr.nr.204/18, Pkr.nr. 305/16, Pkr.nr. 610/16, PS.nr.17/20, Pkr.nr. 40/18, PS.nr.10/20, Pkr.nr. 206/16, Pkr.nr. 90/18, Pkr.nr. 230/18

73 GjTH në Pejë: Rastet me nr. të lëndës: Pkr.nr. 227/16, Pkr.nr. 168/16, Pkr.nr. 25/18,

74 GjTH në Prizren: Rastet me nr. të lëndës: Pkr.nr. 10/18, Pkr.nr. 87/18,

75 GjTH në Gjakovë: Rastet me nr. të lëndës: Pkr.nr. 64/18, Pkr.nr. 110/19.



Gjatë monitorimit shtator 2019 – gusht 2020 Organizata ÇOHU! ka identifikuar **16 raste** të korrupsionit të nivelit të lartë.

izuar me shtyrje të shumta të cilat kanë shkaktuar zvarritje të procesit gjyqësor, me ç'rast 3 seancat e fundit kishin dështuar radhazi ndërsa 4 seanca të tjera kishin dështuar para mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Korrupsioni i nivelit të lartë mbetet një ndër sfidat madhore të drejtësisë e cila vazhdon të ketë efektet në stagnim të zhvillimit të vendi. Kjo problematikë është identifikuar edhe nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, ani pse një dukuri e tillë do duhej të trajtohej me prioritet nga sistemi i drejtësisë i Republikës së Kosovës.

Një problematikë tjetër është kthimi në rigjykim i rasteve të tilla pas apelimit. Pra, në sistemin e drejtësisë sot zyrtarët e lartë të vendit, vazhdojnë të mos ndëshkohen për akuzat e tyre ose ndaj tyre të shqiptohen dënime të ulëta, kryesisht dënime me kusht. Ndërsa në raste të rralla shqiptohen dënime me burgim. Nga gjetjet e monitorimit rezulton se rastet ndaj të cilave është shqiptuar dënimi me burgim janë kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit.⁷⁶

Një gjë e tillë ishte konstatuar edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2019. Në raport theksohet mungesa e një mbikëqyrjeje efektive gjyqësore duke shtuar kështu faktin e apelimit të vazhdueshëm të rasteve të korrupsionit në instancat më të

larta të gjykatave.⁷⁷

Departamenti Special pranë Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit në Prishtinë është funksionalizuar në korrik të vitit 2019 me qëllim të ngritjes së efikasitetit në luftën kundër dukurive kriminale siç janë korrupsioni, krimi i organizuar, shpëlarja e parave si dhe financimi i terrorizmit.

Në bazë të të dhënave të siguruar nga Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti Special në GJTH në Prishtinë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 ka trashëguar 62 lëndë në punë kishte pranuar 28 lëndë, 27 lëndë të zgjidhura për këtë periudhë raportuese si dhe 93 lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

Sipas akterëve të drejtësisë, ky departament është duke ndihmuar në trajtimin e lëndëve brenda kohës së arsyeshme. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në një intervistë për Organizatën ÇOHU! ka deklaruar se rezultatet konkrete të Departamentit Special janë trajtimi i lëndëve brenda kohës së arsyeshme.⁷⁸

Megjithatë, përkundër përpjekjeve dhe reformave të ndërmarra në drejtësi, rezultatet konkrete të luftimit dhe ndëshkimit të keqpërdoruesve në përgjithësi dhe keqpërdoruesve të pozitave publike në veçanti vazhdojnë të mungojnë.

76 GJTH në Prishtinë, rasti Pkr.nr. 206/19, ndaj të akuzuarve Sh.B, N.Z, H.G dhe M.S, të akuzuar për veprën penale "Shpërdorim i detyrës zyrtare", është kthyer në rigjykim në nëntor të vitit 2018. Seanca e parë pas kthimit në rigjykim nga Gjykata Apelit, ishte caktuar për datën 26 qershor 2020 dhe e njëjta kishte dështuar të mbahet.

GJTH në Prishtinë, rasti i njohur "Stenta 1", ndaj të akuzuarve F.A dhe G.B, është kthyer në rigjykim në dhjetor të vitit 2019. GJTH në Pejë, rasti Pkr.nr. 168/16, ndal të akuzuarve S.B, E.Rr, E.B, F.G, të akuzuar për veprat penale "Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar" dhe "Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë", të ardhurave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare", është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit. Pas kthimit në rigjykim gjykata nuk ka caktuar ende seancë për këtë rast. GJTH në Gjakovë, rasti 110/19, ndaj të akuzuarit B.N, i akuzuar për veprën penale "Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar", është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit. Për këtë rast kanë dështuar të mbahen 2 seanca gjyqësore.

77 Seksioni IV – Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri - Raporti i Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut për vitin 2019 – Kosova; Mars 2020; https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/?fbclid=IwAR3TÉ1077j0tpHazEFq1UKPP0M6ag_akeky96LG65YRÉH2qAy6Qr4PQv4#.XmkyUÉHC_BM.facebook.

78 Intervista me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës: Skënder Çoçaj, 30 korrik 2020, Prishtinë.



7. PERFORMANCA E PROKURORËVE DHE GJYKATËSVE NË PROCEDIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE

Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial i Republikës së Kosovës janë në proces të ndryshimit dhe plotësim-it të rregulloreve për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve me qëllim të ngritjes së efikasitetit në gjykata dhe prokurori.

Disa nga risitë e Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve e cila pritet të miratohet janë:

- 2 Përbërja e Komisioni i Vlerësimi të Performancës, nga 13 anëtarë – gjyqtarë. Nga këta 13 gjyqtarë, 5 anëtarë janë nga radhët e Gjykatës Supreme të Kosovës, katër janë nga Gjykate e Apelit dhe 3 të tjerë vijnë nga Gjykatat Themelore të Kosovës.

- 2 Vlerësimi i Performancës së gjykatësve me mandat fillestar do të bëhet dy herë, një herë në përfundim të trajtimit fillestar ndërsa herën e dytë para përfundimit të mandatit fillestar trevjeçar.

- 3 Faza kryesore e vlerësimit të gjyqtarëve do të jetë në anonimitet të plotë sepse gjyqtari raportues nuk do të jetë në dijeni se cilin gjyqtar është duke e vlerësuar.⁷⁹

Këshilli Prokurorial i Kosovës gjithashtu është në fazën finale të përpilimit të rregullores për vlerësimin e performancës së prokurorëve, qëllimi i së cilës është ngritja e cilësisë së punës së prokurorëve si dhe ngritja

79 Intervista me Kryetarin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve: Muhamet Rexha, 30 korrik 2020, Prishtinë.

e integritetit të prokurorëve. Rregullorja e re synon që të sqarohet roli i Kryeprokurorit dhe mekanizmeve të tjerë siç është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorit.⁸⁰ Rregullorja për vlerësimin e performancës së prokurorëve ka hyrë në fuqi në muajin tetor të vitit 2020.

Në bazë të hulumtimeve të Organizatës ÇOHU! rezulton se, përkundër shkeljeve të konstatuara, asnjë nga gjyqtarët të cilët iu kanë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës deri tani nuk është vlerësuar me “mjaftueshëm” apo “dobët”, ndryshe nga prokurorët, ku nga 57 prokurorë të vlerësuar për vitin 2019, vetëm 2 prej tyre janë vlerësuar me “mjaftueshëm” ndërsa asnjë prokuror nuk është vlerësuar me “dobët”.

Në bazë të gjetjeve të Organizatës ÇOHU! deri tani nuk kemi pasur ndonjë rast kur një prokuror/gjykatës është shkarkuar nga detyra për shkak të performancës së tij apo për shkak të masave disiplinore. Të dhënat tregojnë se procesi i vlerësimit të gjykatësve dhe prokurorëve deri tani ka qenë formal dhe pa rezultate konkrete të punës.

Sistemi i Drejtësisë në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me mungesë të përgjegjësisë dhe transparencës nga prokurorë, gjyqtarë si dhe aktorë të tjerë të drejtësisë.

Një gjë e tillë vazhdon t'i kushtojë vendit me mungesë të besimit nga ana e qytetarëve në sistem të drejtë, të pavarur dhe me integritet.

Sfidat me të cilat ballafaqohet gjyqësori në Kosovë, e të cilat rezultojnë me mungesë efikasiteti në trajtimin e lëndëve në përgjithësi dhe lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në veçanti, kanë vënë në pah edhe dështimet e komisioneve të vlerësimit të performancës në përmbushjen e detyrave të tyre ligjore në rastet e mungesës profesionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve.



Në bazë të hulumtimeve të Organizatës ÇOHU! rezulton se, përkundër shkeljeve të konstatuara, asnjë nga gjyqtarët të cilët iu kanë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës deri tani nuk është vlerësuar me “mjaftueshëm” apo “dobët”, ndryshe nga prokurorët, ku nga 57 prokurorë të vlerësuar për vitin 2019, vetëm 2 prej tyre janë vlerësuar me “mjaftueshëm” ndërsa asnjë prokuror nuk është vlerësuar me “dobët”.

80 Intervista me Drejtorinë Përgjithshme të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës: Lavdim Krasniqi, 28 korrik 2020, Prishtinë.



REKOMANDIMET

- Të respektohet Plani i Veprimit për Menaxhimin e Krizës i KGJK-së⁸¹ duke u bazuar në rekomandimet e institucioneve shëndetësore, si dhe të aprovohet dhe zbatohet udhëzimi i USAID-it për mbajtjen e seancave online në rast rëndimi të gjendjes me COVID – 19;
- Të ndërmerren masa të tjera të nevojshme nga KGJK-ja dhe KPK-ja, me qëllim të parandalimit të zvarritjeve gjyqësore dhe shkeljes së të drejtave të palëve në procedure, për shkak të pandemisë COVID-19;
- Të krijohet dhe zbatohet një strategji/plan nga KGJK, i cili ka për qëllim parandalimin e parashkrimit/vjetërsimit e më shumë se 492 lëndëve penale të rrezikuara nga parashkrimi deri në fund të vitit 2020;
- Të trajtohen me prioritet rastet e vjetra të korrupsionit që të parandalohet parashkrimi i tyre;
- KGJK-ja dhe KPK-ja të identifikojnë lëshimet e prokurorëve dhe gjykatësve në rastet e shtyrjes së seancave dhe fillimit të tyre me vonesë për fajin e tyre si dhe të ndërmerren masat adekuate ndaj tyre për shkak të shtyrjeve dhe vonesave të tilla të cilat kanë zvarritur dhe vazhdojnë të zvarrisin proceset gjyqësore;
- Gjykatat dhe prokuroritë të evidentojnë dhe evitojnë problemet dhe shkaqet teknike të cilat shkaktojnë vonesën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor, mosmbajtjen dhe shtyrjen e tyre;
- Përmes mekanizmave relevantë, KGJK-ja të ndërmarrë masat për identifikimin e arsyeve të parashkrimit të rasteve në gjykata si dhe të shqiptojë masat ndaj gjykatësve për fajin e të cilëve ka ardhur deri te parashkrimi i rasteve penale;
- Gjykatësit të respektojnë afatet ligjore-procedurale me rastin e caktimit dhe mbajtjes së seancave të

81 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Krizës, KGJK mars 2020 - https://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/reports/69352_KGJK_Plani_veprimit_per_menaxhimin_krizes.pdf?fbclid=IéAR1KALMcyqYJlpEB9lan1LkjdOgSUnZ1e8_j1ZUxu9to94y4zysEsDAcQB4.

- shqyrtimit fillestar, dytësor, shqyrtimit kryesor si dhe të respektojnë afatet lidhur me përfundimin e një shqyrtimi kryesor;
- KGJK-ja të krijojë mekanizma për vlerësimin dhe konstatimin e arsyeve të cilat kanë shtyrë në shkeljet e afateve ligjore-procedurale nga ana e gjykatësve me rastin e caktimit dhe mbajtjes së shqyrtimeve fillestare, dytësore dhe atyre kryesore;
 - KGJK-ja të ndërmarrë masa ndaj gjykatësve përkatës në rastet kur konstatohet neglizhencë dhe papërgjegjësi e tyre në rastet e shkeljes së afateve ligjore-procedurale;
 - KGJK-ja dhe KPK-ja të rekrutojnë gjykatës dhe prokurorë të rinj në përputhje me standardin e kategorizimit për numrin e gjykatësve dhe prokurorëve;
 - Përmes mekanizmave për vlerësimin e performancës së gjykatësve dhe prokurorëve, KGJK-ja dhe KPK-ja të bëjnë vlerësimin e performancës së të gjithë gjykatësve dhe prokurorëve sipas metodologjisë standarde;
 - Përmes mekanizmave për vlerësimin e performancës së gjykatësve dhe prokurorëve, KGJK-ja dhe KPK-ja të ndërmarrin masa dhe të zbatojnë masa adekuate ndaj gjykatësve dhe prokurorëve të cilët kanë shfaqur performancë të dobët gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tyre;
 - KGJK-ja dhe KPK-ja të kompletojnë ndryshimet ligjore të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin e performancës së gjykatësve dhe prokurorëve;
 - Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, KGJK-ja dhe KPK-ja të vazhdojnë trajnimin dhe arsimimin e gjykatësve dhe prokurorëve, në veçanti në çështjet e natyrave më komplekse me të cilat ballafaqohen gjykatësit dhe prokurorët;



ANEKS

Rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar ndër vite

Rastet e korrupsionit ndër vite

Përveç monitorimit të rasteve të korrupsionit dhe të krimin të organizuar gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, Organizata ÇOHU! ka vazhduar të krahasojë edhe procedimin e rasteve të tilla ndër vite, si në siste-

min gjyqësor ashtu edhe në atë prokurorial. Për shumë vjet, sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor kanë vazhduar të trajtojnë me prioritet rastet e korrupsionit, efikasiteti i të cilave ka qenë edhe kusht për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Në tabelën në vijim është pasqyruar procedimi i rasteve të korrupsionit për periudhën 2015 – 2020 (gjashtëmuji i parë), derisa vërehet trendi i efikasitetit të lehte të rasteve të zgjidhura në vitet 2016 dhe 2017. Në vitet 2018 dhe 2019 vërehet rënie e theksuar e rasteve të zgjidhura nga ana e sistemit prokurorial.

Procedimi i rasteve të korrupsionit në prokurori sipas viteve (2015 - 2020)

Viti	Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë		Të zgjidhura		Të pazgjidhura	
	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P
2015	539	1,642	412	860	951	2,502	456	921	538	1,640
2016	541	1,667	443	824	984	2,491	461	1,115	447	1,248
2017	410	1,154	443	738	853	1,892	456	1,004	318	741
2018	282	707	385	890	696	1,220	408	772	280	668
2019	248	675	419	896	667	1571	400	771	267	800
2020	267	800	172	343	439	1143	148	319	309	851

Tabela 6: Rastet e korrupsionit në Prokuroritë e Republikës së Kosovës ndër vite

Përderisa në vitin 2016 kishte 661 raste të zgjidhura me 1,115 persona të përfshirë në këto raste, më shumë raste se në vitin paraprak, në vitin 2017 ishte një statistikë përafërsisht e njëjtë e rasteve të zgjidhura – 456 raste me 1,004 persona.

Tutje, duke u bazuar në të dhënat e Këshillit Prokurorial të Kosovës, kjo statistikë bie në vitin 2019, me ç'rast 400 raste me 771 persona janë zgjidhur në të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës në vitin 2019.

Rënie e theksuar e zgjidhjes së rasteve është shënuar në gjysmën e parë të vitit 2020, ku vetëm 148 raste të korrupsionit janë zgjidhur në gjashtëmuorin e parë të këtij viti.

Rënie është shënuar edhe në gjykatat e Republikës së Kosovës. Tabela në vijim pasqyron rastet e korrupsionit të proceduara sipas viteve në gjykatat themelore për periudhën 2015 – 2019).

Numri i rasteve të proceduar në gjykatat themelore, sipas viteve (2015 - 2019)

Viti	Të zgjidhura											
	Të bartura	Të pranuar	Gjithsej në punë	Burg	Gjobë	Kusht	Tjera	Aktgjykime	Parashkrim	Tjera	Gjithsej të zgjidhura	Të mbetura
2015	662	282	944	34	40	53	1	55	13	55	229	671
2016	671	258	929	54	40	67	2	133	20	42	358	571
2017	558	272	572	33	58	70	0	14	14	44	289	539
2018	541	233	774	23	46	57	1	10	10	33	255	518
2019	511	218	729	32	63	45	4	46	9	13	212	517

Tabela 7: Rastet e korrupsionit në Gjykatat Themelore ndër vite

Përderisa në vitin 2016 gjykatat themelore kishin zgjidhur 358 raste, ky numër kishte rënë çdo vit – në 289 në vitin 2017, 255 në vitin 2018, si dhe në vetëm 212 raste të zgjidhura të kësaj natyre në vitin 2019. Shqetësuese mbetet mënyra e zgjidhjes së këtyre rasteve. Nëse për periudhën 2015 – 2019 janë zgjidhur gjithsej 1,343 raste të natyrës së korrupsionit në gjykatat e Kosovës, vetëm 176 prej tyre apo 13% janë dënime me burg. Pjesa tjetër e vendimeve të gjykatave mbeten dënime me gjobe dhe kusht, aktgjykime liruese dhe refuzuese

si dhe raste të parashkuara e të zgjidhura në mënyrë tjetër.

Në tabelën vijuese paraqitet procedimi i rasteve për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare sipas veprave penale në gjykatat themelore në Kosovë gjatë vitit 2019

**Procedimi i rasteve për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar
dhe detyrës zyrtare janar - dhjetor 2019**

Veprat penale	Trashëguara	Të pranuar	Gjithsej në punë	Mënyra e zgjidhjes										
				Llojet e dënimeve				Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Parashkrim	Mënyrë tjetër	Zgjidhura gjithsej	Bartur në kompetencë	Pazgjidhura në fund
				Burg	Gjobë	Kusht	Tjera							
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	177	113	290	15	12	15	2	24	14	6	6	94	0	196
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Konflikti Interestit	5	1	6	0	2	0	0	0	0	0	0	2	0	4
Përvetësimi në detyrë	68	16	84	6	5	3	0	2	0	0	2	18	0	66
Mashtrimi në detyrë	7	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	12	0	12	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	11
Marrja e ryshfetit	46	13	59	6	4	2	0	1	2	0	0	15	0	44
Dhënia e ryshfetit	18	8	26	1	5	5	0	0	0	1	0	12	0	14
Dhënia e ryshfetit zyrt. publik të huaj	2	2	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Ushtrimi i ndikimit	6	2	8	1	0	1	0	0	0	0	0	2	0	6
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	3	1	4	0	0	0	0	0	1	0	0	1	0	3
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	88	9	97	1	5	1	0	1	1	0	0	9	0	88
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	3	1	4	0	1	0	0	0	0	0	1	2	0	2
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë..	2	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Mosraportimi apo raportimi i rremë i pasurisë..	70	51	121	2	29	18	2	0	0	1	4	56	0	65
Total	511	218	729	32	63	45	4	28	18	9	13	212	0	517

Tabela 8: Procedimi i rasteve për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare sipas veprave penale në gjykatat themelore në Kosovë gjatë vitit 2019

Sipas të dhënave të kësaj tablele, vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” si dhe “Mosraportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave..”, janë dy veprat penale me më së shumti raste të proceduara gjatë vitit 2019. Nga gjithsej 290 raste e proceduara gjatë vitit 2019 për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 94 të tilla janë zgjidhur nga gjykatat e Republikës së Kosovës. Nga gjithsej 94 raste e zgjidhura, 15 prej tyre apo 15% janë dënime me burg, derisa për 79 raste të tjera kishte vendime liruese dhe refuzuese, dënime me gjobë dhe me kusht si dhe raste të parashkuara apo edhe të zgjidhura në mënyrë tjetër. Statistikë edhe më shqetësuese mbetet ajo e rasteve nga vepra penale “Mosraportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i

të ardhurave, i dhuratave...” si dhe rastet e zgjidhura nga vepra penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”. Nga gjithsej 121 raste në punë të kësaj natyre gjatë vitit 2019, janë zgjidhur gjithsej 56 raste, prej të cilëve vetëm 2 raste apo 3% e tyre janë me dënime me burg. Pjesa tjetër është zgjidhur në format e tjera.

“Falsifikimi i Dokumentit Zyrtar” është vepra tjetër penale në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, ku gjykatat kishin zgjidhur vetëm 9 raste nga gjithsej 97 raste në punë gjatë vitit 2019. Vetëm njëri nga 9 raste e zgjidhura është me dënim me burg. Tabela tjetër vijuese pasqyron procedimin e rasteve të korrupsionit në gjykatat themelore të Kosovës gjatë vitit 2019.

Gjendja me lëndët në gjykatat e rregullta gjatë vitit 2019 (janar - dhjetor 2019)

Procedimi i rasteve për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare janar - dhjetor 2019	Mënyra e zgjidhjes													
	Llojet e dënimeve							Mënyra e zgjidhjes						
	Trashëguara	Të pranuar	Gjithsej në punë	Burg	Gjobë	Kusht	Tjera	Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Parashkrim	Mënyrë tjetër	Zgjidhura gjithsej	Bartur në kompetencë	Pazgjidhura në fund
Gjykata Themelore në Prishtinë	225	81	306	10	34	18	2	13	6	5	8	96	0	210
Gjykata Themelore në Gjilan	41	30	71	8	7	3	0	9	3	0	0	30	0	41
Gjykata Themelore në Prizren	41	44	85	5	9	5	0	2	2	3	0	26	0	59
Gjykata Themelore në Mitrovicë	143	25	168	5	1	5	0	1	6	1	1	20	0	148
Gjykata Themelore në Gjakovë	14	13	27	2	5	4	0	1	0	0	1	13	0	14
Gjykata Themelore në Pejë	28	15	43	1	3	7	0	2	1	0	1	15	0	28
Gjykata Themelore në Ferizaj	19	10	29	1	4	3	2	0	0	0	2	12	0	17
Total	511	218	729	32	63	45	4	28	18	9	13	212	0	517

Tabela 9: Procedimi i rasteve për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare në gjykatat themelore në Kosovë gjatë vitit 2019

Gjykatat themelore në Prishtinë dhe Mitrovicë janë dy gjykatat me më së shumti raste në punë gjatë vitit 2019. Nga gjithsej 729 rastet në punë në të gjitha gjykatat, GJTH në Prishtinë numëron 306 të tilla ndërsa ajo në Mitrovicë 168 raste. Nëse shikojmë numrin e rasteve të zgjidhura nga këto dy gjykata, atëherë GJTH në Prishtinë qëndron më efikase me 96 raste të zgjidhura apo 45% të të gjitha rasteve të zgjidhura, mirëpo GJTH në Mitrovicë është ndër gjykatat më joefikase me vetëm 20 raste të zgjidhura gjatë vitit 2019. Gjykata me numrin më të vogël të rasteve të zgjidhura është GJTH në Ferizaj me vetëm 12 raste të zgjidhura, ndërsa që të gjitha gjykatat kishin zgjidhur gjithsej 212 raste të korrupsionit gjatë vitit 2019.

Mungesa e efikasitetit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor në procedimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, në veçanti atij të nivelit të lartë, vazhdon të mbetet ndër defektet e vazhdueshme në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Mungesa e rezultateve të tilla të prokurorisë dhe gjykatave mbetet objekt kritike edhe në vlerësimet dhe publikimet ndërkombëtare, e

që vazhdon t'i kontribuojë brishtësisë së sundimit të ligjit në Kosovë.

Rastet e krimit të organizuar ndër vite

Rastet e krimit të organizuar kanë qenë poashtu objekt i analizës së procedimit të rasteve ndër vite nga Organizata ÇOHU! Njëjtë si prokuroria, edhe gjykatat kanë pasur trend të ndryshëm të procedimit të rasteve të kësaj natyre ndër vite, me ç'rast vlen të theksohet rënia e efikasitetit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 në sistemin prokurorial.

Sipas të dhënave të siguruara nga sistemi prokurorial, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, sistemi prokurorial ka pasur të pazgjidhura gjithsej 34 raste me 188 persona, të pasqyruara edhe në tabelën në vijim:

Procedimi i rasteve të krimit të organizuar në prokurori sipas viteve (2015 - 2020)

Viti	Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë		Të zgjidhura		Të pazgjidhura	
	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P
2015	41	311	14	156	146	467	16	113	47	354
2016	49	420	2	27	51	447	23	185	40	344
2017	42	353	13	94	55	447	7	126	50	250
2018	42	227	6	34	48	261	13	70	35	191
2019	39	207	8	76	47	283	13	106	34	177
2020	34	177	4	34	38	211	5	28	34	188

Tabela 10: Rastet e krimit të organizuar në Prokuroritë e Republikës së Kosovës ndër vite

Sipas të dhënave të siguruara në Këshillin Prokurorial të Kosovës, në dy vitet paraprake prokuroritë kishin zgjidhur nga 13 raste të krimit të organizuar, nga 6 raste më shumë sesa në vitin paraprak, përkatësisht në vitin 2017. Mirëpo një rënie e efikasitetit vërehet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, krahasuar me dy vitet paraprake. Duke u bazuar në po këto të dhëna, vetëm 5 raste të krimit të organizuar me 28 persona janë zgjidhur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 nga prokuroritë e Republikës së Kosovës, me ç'rast në fund

mbeten të pazgjidhura 34 raste me 188 persona (30 qershor 2020).

Njëjtë si prokuroritë, edhe gjykatat kanë vazhduar të kenë numër të konsiderueshëm të rasteve të pazgjidhura krahasuar me rastet e zgjidhura. Në tabelën në vijim paraqitet procedimi i rasteve të krimit të organizuar për periudhën 2015 – 2019 në gjykatat themelore të Kosovës:

Viti	Numri i rasteve të krimit të organizuar të proceduar në gjykata themelore, sipas viteve (2015 – 2019)											
	Të bartura	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të zgjidhura							Gjithsej të zgjidhura	Të mbetura
				Burg	Gjobë	Kusht	Tjera	Aktgjykime	Parashkrim	Tjera		
2015	35	13	48	1	0	0	0	0	0	1	2	46
2016	46	15	61	3	0	0	0	0	0	0	3	59
2017	57	5	62	3	1	0	0	0	0	1	5	57
2018	57	11	68	4	0	0	0	0	0	2	6	62
2019	57	6	63	2	1	1	1	1	0	1	7	55

Tabela 11: Rastet e krimit të organizuar në Gjykatat Themelore, ndër vite

Duke u bazuar në këto të dhëna, rastet e zgjidhura të krimit të organizuar kanë shënuar rritje nga viti në vit, mirëpo mbetën numër i konsiderueshëm i rasteve të pazgjidhura në fund. Sipas po këtyre të dhënave, nga gjithsej 7 rastet e zgjidhura të krimit të organizuar gjatë

vitet 2019, vetëm 2 prej tyre apo 28% janë dënime me burg. Në gjykatat themelore ende mbetën të pazgjidhura 55 raste të krimit të organizuar.



Parashkrimi i lëndëve në gjykata themelore

Parashkrimi i lëndëve në gjykata në periudhën 2000 - 2019

Gjykata/Viti	2000/2010	2011/12	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Totali
GJTH Prishtinë	276	242	105	163	221	968	1,176	1,471	1,259	5,881
Lipjan	17	67	0	2	3	3	18	23	45	178
Podujevë	0	0	485	332	344	280	230	208	133	2,012
Drenas	4	0	2	8	1	6	2	1	-	24
Graçanicë	-	-	-	-	-	-	-	0	0	0
GJTH Prizren	1,536	15	709	295	122	149	214	284	130	3,454
Suharekë	78	101	57	107	56	36	65	35	39	574
Dragash	2	17	11	6	23	12	21	23	13	115
GJTH Pejë	435	13	27	15	10	7	3	12	0	522
Klinë	299	224	63	12	149	64	20	22	11	864
Istog	242	307	172	45	77	37	18	9	0	907
Deçan	514	27	5	17	56	33	1	8	19	680
GJTH Gjilan	0	0	136	116	157	113	177	85	117	901
Kamenicë	140	77	41	33	16	13	43	25	25	413
Viti	0	0	90	48	34	65	80	46	15	378
Novobërdë	0	0	20	7	6	2	8	2	0	45
GJTH Ferizaj	870	369	53	249	374	354	260	237	266	3,032
Kaçanik	93	166	88	52	53	55	64	87	17	675
Shtërpcë	3	15	6	9	7	3	22	18	10	93
GJTH Gjakovë	461	120	15	34	44	26	34	27	29	790
Rahovec	1,049	0	65	160	38	107	70	44	35	1,568
Malishevë	214	79	44	53	49	37	60	39	48	623
GJTH Mitrovicë	0	0	19	270	185	752	246	123	105	1,700
Vushtrri	151	24	10	9	16	8	1	25	20	264
Skenderaj	13	14	7	10	4	8	12	42	13	123
Leposaviq	-	-	-	-	-	-	-	28	62	90
Zubin Potok	-	-	-	-	-	-	-	0	3	3
Total	6,397	1,877	2,230	2,052	2,045	3,138	2,845	2,923	2,414	25,909

Tabela 12: Parashkrimi i lëndëve në gjykatat themelore, ndër vite



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



Kingdom of the Netherlands